

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI

Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA

Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7580 E premte 6 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

**E**kush nuk e dëgjoji thjesht kumbimin, por gjësimin e këtyre kambanave politike ditë e fundit në Berlin dhe në Mynih kur CDU/CSU, dy parti ...  
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

**Kambanat bien për multilateralizmin**



Opinion

Ditës

**P**arë me një sy pa pasione, seanca e sotme nga pikëpamja e korrupsionit nuk ka asgjë të veçantë. Në një krah ishin socialistët që mbrojnë kalimin e pronës publike ...  
Vijon në faqen 21

Nga DRITAN HILA

**Nuk është vetëm teatri, ka akoma**



Tensioni, deputetët gjuajnë me kartonët e kuq

## Opozita bllokon foltoren, Kuvendi miraton ligjin për shembjen e Teatrit

75 vota i hapin rrugen Teatrit të ri. Artistet në proteste para parlamentit


DARINA TANUSHI

Mazhoranca votoi dje me 75 vota "pro", ndihmuar edhe nga dy deputetë të PDIU-së dhe ish-deputeti i LSI-së, Robert Bitri ligjin për ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar. Pas 12 orësh debati në sallën e Kuvendit, opozita tentoi ...  
Në faqen 2-5

**TOKAT E ZENA NGA NDERTIMET PA LEJE, NDAHET FONDI 732 MILIONE LEKE**

## KOMPENSIMI, LISTA ME 1200 PRONARET QË MARRIN PARATE

Emrat e familjeve në Tiranë dhe në rrethe. Vendimi i qeverisë publikohet në Fletoren Zyrtare, procedura që duhet të ndjekin përfituesit



(Në foto) Ndërtime pa leje

Në faqen 10-13

PAS VOTIMIT

**Teatri, Lulzim Basha: Vendim antihistorik. Kryemadhi: Një ditë do veprojë drejtësia**

Në faqen 2

KONKURRENCA

**Çmimet e frutave e perimeve, hetim për abuzim me pozitën monopol**

Në faqen 14

VETINGU

**KPK-ja shkarkon prokurorin e Apelit: Pasuria, probleme me deklarimin**

Në faqen 15

"VRASJA E SHEKULLIT"

**Dënimi me 25 vite burg, Izet Haxhia ankimon vendimin e gjykatës**

Në faqen 9

AMBASADORI I SHBA



**Lu para largimit: Kokat e krimit të kenë frikë, drejtësia po vjen**

Në faqen 7

Ambasada amerikane në Tiranë: Ja kategoritë që mund të përfitojnë bursa

## Studimet në SHBA, 5 hapat për të fituar

Nuk ka kriter moshe për t'u pranuar. Aplikimet, direkt në universitete

Nga VOLTIZA DURO

Studentët që janë të interesuar të ndjekin një prej programeve të studimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, tashmë mund të njihen me procedurat kryesore të aplikimit për t'u shpallur fitues. Ditën e djeshme,



ambasada amerikane në Tiranë ka bërë një njoftim të rëndësishëm për të gjithë të interesuarit e më tej ka sqaruar kandidatët mbi 5 hapat që duhet të ndjekin. "Para se të aplikojnë për një vizë, të gjithë aplikantët për vizë studentore ...

Në faqen 16

## VOTIMI NE KUVEND DEBATI

Valentina Madani

Kuvendi u përfshi dje nga një debat maratonë për projektligjin për Teatrin Kombëtar. Opozita kundërshtoi shembjen e Teatrit, por e ndërgjegjshme së shumica i ka votat për ligjin, i bëri thirrje Presidentit Ilir Meta që të mos e dekretojë draftin e qeverisë. Që në nisje të seancës, kreu i PD-së Lulzim Basha kërkoi në parlament, që të vinte Kryeministri Rama të jepte shpjegime për atë që ai e konsideron si vjedhjen 200 mln euro për Teatrin Kombëtar. Teksa kreu demokratik fliste, nga salla dikush qeshte. Kjo bëri që Basha t'i drejtohej me fjalët: "Mos u zgërdhni, hajdutë!". "Keni sjellë një projektligj me urgjencë, për të vjedhur Teatrin, për të pastruar 200 milionë euro të drogës, po përdorni procedurën me urgjencë. Emergjencën tuaj për të vjedhur e ka kuptuar gjithkush, edhe ata qindra mijëra qytetarë dhe artistë që po protestojnë jashtë. Mos u zgërdhni! Hajdutë qepen gojën! Por, që mos t'i përgjigjesh as pyetjeve të opozitës ç'kuptim ka ky parlament? Ç'kuptim ka që të vazhdojmë këtu, në qoftë se bedelët e kryehajdutit vijnë dhe as nuk i përgjigjen pyetjeve të opozitës? Çfarë kujton se jeni ju more? Çfarë mendoni, nga e keni marrë pushtetin? Mendoni se ata kriminelë dhe ato lekë droge që ju kanë dhënë pushtetin do t'ju mbrojnë deri në fund? Po i vini flakën parlamentit. Thirrni mendjes! Thirrni mendjes! Në krevat me krimin. Tenderët me krimin", -tha z.Basha. Kreu i PD-së foli për përgjigje të deputetëve socialiste nga agjencitë partnere ndërkombëtare. "Derrkuci i 'Toyota Yaris' do të heq vëmendjen nga rendi i ditës". Derrkuci i 'Toyota Yaris' më akuzon mua se kam dalë me vëllain e personave që u dyshohkan se janë parave të 'Toyota's. Ju keni vëllain e trafikantit të dënuar ministër të Brendshëm. Hani darka dhe dreka me të. Merreni dhe arrestoni nëse është i dyshuar. Derrkuci i 'Toyota Yaris', garantit i parave të pista të drogës dhe nja dy të tjerë që nuk qenkan në sallë këtu, jeni të përgjuar nga shërbimet partnere. Nuk keni për t'i shpëtuar dot kësaj. Jeni të përgjuar nga shërbimet partnere duke bërë pazar me Bacën në Selanik. Ah sa keq! Shërbimet tona flenë gjumë. E keni kapur SHISH-n, po tjerat nuk i kapni dot. Jeni të përgjuar duke dhënë garanci. Ua kanë vënë kryqin. Nga Uashingtoni në Bruksel, nga Berlioni në Romë. Ua kanë vënë kryqin.

Ligji për teatrin, Berisha-mazhorancës: Ndaluni, jeni bërë simbol i krimit

# Basha, akuza Ramës: Hajdutë, flini në krevat me krimin

"3 deputetë të PS bënë pazar me Bacën në Selanik!"



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në Kuvend

## Kryemadhi, Ramës: Mua më ke në radhë të parë, edhe 100 vetë të zbythin

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, deklaroi dje në Kuvend se ajo do të jetë e para kundër ruspave nëse vendoset që do të shembet Teatri. Ajo i tha Ramës se është vetëm dhe nuk mund t'u mbyll gojën shqiptarëve. Mendova se do ta shembte natën dhe do thoshte e rrëzoi tërmeti, por nuk i ka shkuar në mendje se nuk dihet se në ca efekti ka qenë. "Në kujtim të artistëve të mëdhenj që kanë luajtur në atë skenë dhe na skalitën shqiptarizmin, ky antishqiptar kërkoi ta rrëzojë. Për të kthyer vlerat e imoralitetit dhe të drogës. Por edhe për LGBT, e them këtë se besoj në zot. Unë do jem në resht të parë përpara të ruspave të Ramës, do jem aty se nuk ke parë asgjë akoma. Ti me paratë e dogës po blen median dhe prokurorinë, por gojën e shqiptarëve nuk e mbyll dot. Ti je vetëm, paraja nuk është shoku i mirë. Paraja është një shok i keq, të hedh atje ku ti nuk e pret. Tani grabit me ligj, paratë e buxhetit, me PPT e famshme, kushedi çdo shpikë ndonjë gjë tjetër, ne sot nuk i kemi votat për ta rrëzuar ligjin, ju i keni dhe shumë mirë, por ju e dini shumë mirë që mjaftojnë 100 vota për t'u zbythur nga krimi, e patë ca ndodhi me rrugën e Kukësit", -deklaroi zj.Kryemadhi.

Kryqin e madh do t'ua vënë shqiptarët shumë shpejt", -theksoi z.Basha. Edhe ish-kryeministri Sali Berisha e konsideroi vjedhjen nga kryeministri atë të po ndodh me hapësirën e Teatrit Kombëtar, duke nënvizuar se shpejtësia me të cilën sillej ligji është e pa imagjin-

ueshme. Berisha i bëri thirrje mazhorancës që mos votojnë pr/ligjin për teatrin. Berisha u shpreh se Shqipëria është kthyer në simbol të krimit dhe drogës. "Nuk ka krim më të shëmtuar, nuk ka dëshmi më flagrante të shndërrimit në mafie të kësaj pseudomazhorance sesa pro-

### ERVIN SALIANJI

"Qeveria në këto vite ka dëmtuar dhe ka vjedhur ku të ketë e mundur. Për të pastruar para po i jep një pronë 'Fusha SHPK'. Sulejman Fusha, një i afër i 'Fusha SHPK', është i dënuar në Spanjë për trafik ndërkombëtar droge, me 56 kilogramë heroinë. Si ka mundësi që në këtë vend çdo aktivitet ekonomik, lidhet me persona që kanë lidhje, apo kanë të afërm të lidhur me trafikun e drogës", - tha Saliiani.



Seanca e djeshme parlamentare

## "Po luhet drama e jashtëzakonshme e 'Arturo Ui'"

Bylykbashi: Po shkatërroni gjithçka të ndërtuar para vitit '44, do shkoni në burg!

Deputeti demokrat Oerd Bylykbashi akuzoi dje qeverinë për shkatërrim e grabitje të pronës publike dhe u shpreh se njerëz do shkojnë në burg për projektligjin e teatrit, që sipas tij është antikushitetues. "Ju po shkatërroni çdo gjë nga themelimi i kryeqytetit deri në ditën kur morët pushtetin me armë, 29 nëntor 1944", u shpreh ai në Kuvend. Bylykbashi i cilësoi deputetët socialistë si marioneta në duart e kryeministrit, projektligjin për Teatrin Kombëtar e krahasoi me dramën e "Arturo Ui". "Në teatrin që ju planifikoni të prishni po luhet drama e jashtëzakonshme e 'Arturo Ui', bosi i trustit të lulelakra. Askush s'e kishte menduar se drama do luhej në këtë sallë dhe 'Arturo Ui' do ishte kryeministri që keni ju sot për kryeministër. Banda e 'Arturo Ui' është këshilli i tij i ministrave dhe iu do ishit ata ushtarët e sejmënët e tij.



### JORIDA TABAKU

"Më shumë se kushdo, unë dhe familja ime kemi vuajtur regjimin e Enver Hoxhës dhe të Edi Ramës, në vjedhjen e pronës. Ju nuk keni lënë qytetarë të këtij vendi të ndërtojë, nuk keni lënë ata që kanë të drejtën e tyre të pronës, e sot po merrni një pronë publike dhe e falni si plaçkë. Sot po bëheni gardh për vjedhjen dhe abuzimin. Nuk e kuptoj dot se si mund të ngrini kartonët", - tha znj.Tabaku.

Ndërkohë që Gëbelin apo Zhivolën e ka në bashkinë e Tiranës. Po na thonë që keni shpikur diçka inovative. Njëpër një PPP, kësaj PPP-je origjinale po zhvillojnë Shqipërinë. Në fakt, kjo PPP juaj

është trusti që ka në krye Edi Ramën kryeministër. Ka një nen dhe Kod Penal që është më fleksibël se çdo ligj që do bëni këtu dhe njerëz do shkojnë në burg për këtë", -tha z.Bylykbashi.

cedura urgjente e ligjit për të shkatërruar një simbol kombëtar. E mora fjalën për procedurë për të kërkuar anulimin e menjëhershëm të këtij akti supermafioz. A ka shqiptar që mund të imagjinojë se ligji për teatrin, duhet të ishte një ligj me superurgjencë parlamentare në

një kohë kur keni shndërruar Shqipërinë në eksportues droge. Në një kohë kur jeni bërë simbole të krimit dhe drogës, larjes së parave, të vrasjeve shtetërore në zyrë, nuk dini të ndaleni, ndaluni për një moment, se prapa këtij krimi qëndrojnë qindra milionë euro të 'Toyota





Tensione dhe akuza në Kuvend, ironia e kryeministrit me deputetët e opozitës

# PS voton me 75 vota ligjin për teatrin, opozita gjuan me kartonë të kuq ministrat

Mima, Ramës: E largove Majkon që të mos votonte kundër

Darina Tanushi

Mazhoranca votoi djete me 75 vota "pro", ndihmuar edhe nga dy deputetë të PDIU-së dhe ish-deputeti i LSI-së, Robert Bitri ligjin për ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar. Pas 12 orësh debati në sallën e Kuvendit, opozita tentoi të bllokojë foltoren në fund të seancës, për të bllokuar miratimin e ligjit, ndërsa jashtë vijonin protestat. Por në minutat e fundit deputetët e PD-së dhe të LSI-së kanë hedhur kartonët drejt kryeministrit e ministrave dhe kanë lënë sallën e seancës parlamentare. Në këtë moment është dëgjuar edhe një ironi e kryeministrit Rama, i cili nuk ka folur në seancën e djeshme. "Edhe kartonët që gjuan janë jeshilë", është dëgjuar të thotë Rama. Në këtë votim është parë të mungojë edhe ministri Pandeli Majko, për të cilin deputeti demokrat, Florian Mima iu drejtua kryeministrit Rama duke e pyetur nëse e ka larguar ai për të shmangur një votë kundër. Kryetari i grupit parlamentar të PD-së, Edmond Spaho i bëri thirrje para votimit grupit parlamentar të PS-së e kryeministrit Rama të tërhiqte projektligjin. "I bëj thirrje kësaj mazhorance të tërheqë këtë barabarizim, pasi qyteti nuk i ka asnjë kusur që për interesa private të kryeministrit, pangopësinë e tij të mund të shëmtohet dhe shkatërrohet sikundër do ta bëjë ai. Ne si opozitë nuk do ta lejojmë", tha Spaho duke qëndruar për disa momente në foltore, ndjekur edhe nga deputetët e tjerë. Më herët pati mjaft tensione dhe akuza mes palëve.



**REAGIMI I BASHËS**

"Vendimi që sapo morën Edi Rama dhe banda e tij në Kuvend është antikombëtar, antihistorik dhe i turpshëm. Votimi tregoi se Rama me hajdutët e tij janë në unitet të plotë për të grabitur Shqipërinë. Ne do t'i tregojmë kësaj bande se pushteti është i popullit dhe jo i saj, duke mos lejuar në asnjë mënyrë prishjen e teatrit, duke e mbrojtur atë edhe me trupat tanë. Rama tani do të kuptojë se qytetarët e bashkuar janë më të fortë se hajdutët e bashkuar", tha Basha pas votimit.

**DEBATI RAMA-MAJKO**

Gjatë seancës së djeshme është vënë re që kryeministri Edi Rama dhe ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko kanë debatuar për disa minuta me njëri-tjetrin. Debati është kapur nga kamerat e televizioneve dhe është vënë re se në të ka ndërhyrë edhe ministri Xhafaj. Deputeti i PD-së, Florian Mima ka sulmuar që në nisje të seancës kryeministrit Edi Rama, ndërsa ka zbuluar edhe një detaj lidhur me këtë sherr që ka ndodhur mes kreut të qeverisë dhe ministrit Pandeli Majko, i cili u largua nga Kuvendi. "Nuk po shikoj zotin Majko në sallë, sapo e përzuri. Nuk e di nëse e përzutë ju Majkon, apo iku vetë. Mos e prishni teatrin, o delenxhinj", pohoi Mima, njëherësh djali i aktorit të famshëm Prokop Mima. Ndërkohë, deputetë të PD deklaruan se kanë dëgjuar kryeministrit Edi Rama që të debatojë për këtë çështje me Majkon.

**MONIKA KRYEMADHI**

Tentakulat e banditizmit të qeverisë sot u shtrinë te teatri! Sepse në këtë vend nuk ka më institucione drejtësie, ka vetëm lakej të Edi Ramës. Por fundi i diktatorëve është i shkruar qartas dhe atë nuk e lexon vetëm kryeministri ynë dhe qeveria e tij. Drejtësia do të rëndojë një ditë mbi ta dhe të gjithë autorët dhe zbatuesit e masakrës do të përgjigjen për këtë akt, nga më të shëmtuarit që ka votuar ky parlament!



## Ahmetaj: Teatri i ri, artistët e qytetarët marrin 8 herë më shumë

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj Lu ka kthyer përgjigje 40 pyetjeve të LSI-së për projektligjin për Teatrin Kombëtar. Ahmetaj tha se sipërfaqja e Teatrit Kombëtar e ndërtuar do të rritet nga 1126 në 9 mijë metra katrorë, një rritje 8 herë më e madhe që sipas tij e përfitojnë qytetarët dhe artistët. Për më tepër, ministri theksoi se shteti harxhon zero lekë dhe teatri bëhet në të njëjtën pronë me 4 salla. "Natyrshëm, unë e mirëkuptoj debatin që ekstremizohet me debat politik, pastaj ekstremizim me sharje e fyerje. Është histori tjetër besoj, nuk është vendi për të shkëmbyer sharje e fyerje, por domosdoshmëri për të sqaruar. Ka qenë kusht i artistëve dhe aktorëve. Kjo pjesë e shkruar si vijë e kuqe ku interesi publik mbrohet në rritje. Nëse ndërtesa sot ka brenda 1126 metra katrorë, kanë rënë dakord që nuk është funksionale. Çfarë merr në këmbim shteti, teatri, qytetarët? Në këmbim merr 9 mijë metra katrorë ndërtim me zero lekë. Buxheti i shtetit harxhon zero lekë në të njëjtën pronë. Seancën e sharjeve t'ia lëmë momentin të fundit", sqaroi ministri Ahmetaj. Ai tha se artistët përfitojnë 4 salla, një sallë është me 600 vende, 2 salla të tjera me nga 100 vende dhe ka dhe një sallë tjetër, amfiteatër jashtë në katin e tretë dhe nuk ka më asnjë vend privati.

## Kreu i LZHK-së sulmon kryeministrit: Teatri, evropian

### Shehi: Unë hoqa dorë nga pronat e mia, ti i je vënë pas teatrit për 20 vjet

Kreu i LZHK-së, Dashamir Shehi nga foltorja e Kuvendit ka sulmuar ashpër kryeministritin Edi Rama lidhur me çështjen e këtyre ditëve, por edhe kryefjalën e debatit të sotëm, Teatrin Kombëtar. Përmes një fjalimi të fortë Shehi pohoi se teatri është e vetmja vlerë që ka qendra e Tiranës, ndërsa nënvizoi rëndësinë që të ruhet historia e qytetit. Ai e cilësoi projektligjin për teatrin një vjedhje të pastër. Po ashtu, ai mori si shembull edhe një eksperiencë të tijen personale, ndërsa tregoi se kishte hequr dorë nga pronat e tij



të ligjshme, ndërsa sipas tij, Rama kishte 20 vjet që ishte vënë pas teatrit. "Ky Kuvend ka halle të tjera, por ka edhe hallat e parave. Kam pasur një tufë pronash në Tiranë dhe në Shqipëri, tek viti i tretë u mërzita dhe hoqa dorë, që ishin dhe tokat e babait tim

të ligjshme. Kurse ky (Rama) ka 20 vjet vetëm do të marrë atë pronën atje. Kjo qoshe e Tiranës, jo vetëm për ne që jemi të këtij qytetit, është hapësira publike më e nderuar për t'u mbajtur. Nuk ka asnjë vend tjetër në Shqipëri që mund të jetë shkruar aq shumë. Nëse ka diçka europiane ky qytet, se shumicën e shkatërroi Enver Hoxha, por nëse ka ngulur diçka që përfaqëson qytetin është kjo këtu (Teatri). Ai nga ana e urbanistikës është i vjetër, por po që për pallatë të reja, Europa është e mbushur", tha Shehi.

oni se nuk keni çfarë të bëni gjë tjetër. Ju nuk keni axhendë, nuk keni ekip, nuk keni program dhe le të më thotë njëri një projektligj që ka sjellë opozita. Se për të protestuar keni protestuar për gjithçka dhe kundër gjithçkaje", u shpreh Balla. Sekuestrimi i 3.4 milionë eurove në

"Toyota Auris" pak ditë më parë nxiti sërish debatin në Kuvend, ku palët vijuan me akuza të ndërsjella. Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla u shpreh se "vëllai i dy personave në kërkim ka qenë sponsorizues i mirëmbajtjes së çadrës së opozitës në bule-

vard". "Vëllai i dy personave në kërkim ka qenë me dhjetëra herë në çadrën tënde. Ata kanë qenë edhe sponsorizues të mirëmbajtjes së çadrës tënde. Për të gjitha këto të pres të martën në seancë në Gjykatën e Krimeve të Rënda", iu drejtua Balla, kreut të PD-së.

## TEATRI PROTESTA E ARTISTEVE

Liçaj: Votoni si shqiptarë me zemër, Saimir Kumbaro: Nuk mund të shkatërrohet memoria

# Artistët para parlamentit: Mos na detyroni të ngujohemi

Qindra në protestën kundër shembjes së teatrit

Fatmira Nikolli

Dhjetëra artistë e qindra qytetarë kanë protestuar dje para parlamentit, ndërsa në secancë pritej të votohej ligji që i hap rrugë shembjes së dy teatrove kombëtarë dhe ndërtimit të një të riu me PPP. Me pankartat "Urëdhërsa numër 8- mos vidh", "Teatri është gracka ku shpirti i kryeministrit kapet si Laraska", "Mbroteatrin", "Unë jam teatri", ata kanë qëndruar për orë të tëra në protestë edhe rrezet e diellit të mesditës e bënë të pamundur. Protesta nisi në orën 10:00 dhe deri në orën 13:00 kur mbaronte leja e marrë te policia, hyrja e parlamentit ishte plot. Më pas, qytetarët ikën dhe mbetën artistët që protestojnë për natë bashkë me shoqërinë civile. Sokol Angjeli, Bujar Asqeriu, Neritan Liçaj, Suela Bako, Alert Çeloalija, Mehdi Malka, Sesilia Plasari.

### FJALIMET KUNDËR LIGJIT

Pesë muaj më pas, pak ka mbetur për t'u thënë e re në argumentet në mbrojtje të teatrit. Qytetarët që nuk kishin firmosur hodhën firmat, ndërsa artistët, që mbanin në duar pankartat, u bënë thirrje deputetëve të mos votojnë. Aktori Alert Çeloalija, tha dje se, nëse miratohet ligji, nuk do të ketë grevë, por vetëm protestë ose ngujim.

"Nëse miratohet ligji do të kthehemi në teatër, mos t'u shkojë mendja për grevë urie, sepse unë i pari nuk rri në grevë urie. Por, do të shkojmë tek sheshi i teatrit dhe do të komunikojmë për masat që do të marrim. Grevë urie nuk ka, mund të ketë përshkallëzim protestash ose edhe për ngujim kemi diskutuar".

Regjisori i njohur Robert Budina u shpreh se sot protestojnë për projektligjin e teatrit dhe se do t'i japim një mesazh politikës, e cila sot duhet të reflektojë mbi teatrin. "Sot i themi qeverisë të



### KËNGË PATRIOTIKE

Në momente të ndryshme të protestës janë kënduar edhe këngë patriotike. Vetë fjalimet e protestës nisën me Himnin e Flamurit për të vijuar me "Për mëmëdhenë" apo "Xhamadani Vija-Vija". Këngët u kënduan njëzëri nga të gjithë të pranishmit që edhe pse në temperaturat e larta të ditës së djeshme qëndruan në diell.

## Bujar Asqeriu, deputetëve: Mos i ngulni dhëmbët mbi Teatrin

Ka qenë dje i pranishëm në protestë edhe aktori i njohur Bujar Asqeriu. Gjithnjë, kur ka dalë të flasë, fjalimet e tij janë bërë virale. Edhe dje, ai i bëri një thirrje të fortë deputetëve teksa u kërkoi për herë të fundit të mos e votonin projektligjin duke u kërkuar madje "të mos ngulni dhëmbët mbi Teatrin tonë Kombëtar".

"Jemi këtu për të mbrojtur historinë tonë, një popull pa histori e pa art, nuk ka jetë. Jemi këtu që të ngrihemi mbi mashtrimet e qeveritarëve tanë. Jemi këtu për t'i dhënë në kuptim jetës së çdo shqip-



tari. Parlamenti ynë të mendohet mirë para se të votojë këtë ligj, për të kafshuar Teatrin Kombëtar. Kini Kujdes mos luani me artistët, artistë janë njerëzit më të nderuar të kombit. Prandaj kujdes me artistët. Të nderu-

ar deputetë kalojeni këtë nen me shpirt dhe do të kuptoni thellë se nëse votoni këtë ligj do të bëni një hap të gabuar. Nëse dhëmbët tuaja do të ngulen në atë Teatër nuk do të harrohen kurrë", tha Asqeriu.

### TYMUESËT

Ndonëse protesta ka qenë e qetë, rreth orës 11:00 tymuese janë hedhur pranë parlamentit. Megjithatë u raportua se janë hedhur nga protestuesit, askush nuk pa të hidhen. Forcat policore që rrethonin parlamentin, i kërkuan Robert Budinës të "mbante rregull" dhe organizatorët e protestës bënë thirrje që protestuesit të jenë paqësorë.

reflektojë, ne do të bëjmë detyrën tonë dhe do të jemi në bashkëpunim të ngushtë

me policinë. Ne do t'i japim një mesazh politikës, do të bëjmë rezistencë. Ky është

një proces dhe ne nuk jemi të orientuar pasi nuk ka një grup që do të merret me këtë projektligj. Teatri nuk duhet të përballet, këtë po përpiqemi të përçojmë sot. Qeveria mund ta shkelë ligjin, por ne jo. Ne do të jemi në Teatrin Kombëtar", tha Budina.

Aktori Neritan Liçaj kërkoi sërish që projektligji të mos kalojë, duke ngulmuar për protestë paqësore



Protesta e djeshme e artistëve

## Thirrjet



### PANKARTAT

Organizatorët e protestës u munduan që të mbajnë fokusin e protestës vetëm te çështja e Teatrit Kombëtar, duke u përpjekur që të shmangnin thirrjet "Rama ik" apo akuzat e tjera politike që nuk munguan nga protestuesit. Alert Çeloalija u bëri thirrje të pranishmëve të mos bëjnë politikë, por të merren me teatrin.

e qytetare. Duke ju drejtuar deputetëve, ai tha: "Mos e kaloni këtë ligj. Është një ligj i papranueshëm. Në çdo logjikë. Votoni si shqiptarë me zemër. Votoni Kuq e Zi. Shqiptarët janë larë në gjak ndër shekuj për një Universitet, Teatër. Nëse projektligji votohet do të ndërmarim hapat tanë, por si gjithmonë në mënyrë civile. Unë shpresoj të mos votohet projektligji. Tërheqjen e tij do ta konsideroja një qytetari. Theksoj shprehjen e Nënë Terezës se le të kujtojmë se i përkasim njëri-tjetrit dhe të gjejmë paqe. Ne aktorët e kemi thënë fjalën tonë".

Edhe aktoria Anila Bisha i ka bërë thirrje qeverisë dhe parlamentit të mos votojë projektligjin për nisjen e negociatave për ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar. "Ju deputetë keni shansin të tregoni që jeni të drejtë. Justifikoni betimin që keni bërë. Nuk e di çdo ndodhë, por shpresoj të kenë ndërgeje. Mos u udhëhiqni nga lideri juaj. Nëse votohet kjo është dita më e zeze, sepse do të na kthejë 50 vjet prapa".

Regjisorja Suela Bako bëri dje thirrjen e fundit, që mos të thyhet shpresa e njerëzve, që kanë zgjedhur të jetojnë në këtë vend. Regjisorja dhe aktoria Bako

kërkoi, si qytetare edhe si nënë, që mos t'ua thyejnë shpresat dhe ëndrrat, që ajo edhe familja e saj kanë thurur. "Unë jam çame, jam aktore edhe regjisorë, unë jam një kriminele luftime edhe një kriminele paqeje. Nuk e di se si do të ndihen nesër fëmijët e mi, por për një gjë do të ndihen krenarë, që ne në asnjë moment nuk u dorëzuam përballë kësaj arrogance edhe kësaj padrejtësie".

I pranishëm ishte edhe regjisori Saimir Kumbaro. Me një kamera në dorë, duke xhiruar ajo jo vetëm mbështeti artistët ai tha se do filmojë këtë moment historik dhe shtoi se e konsideron prishjen e teatrit, një veprim që tregon edhe nivelin intelektual të vendimmarrësve. "Të prishësh teatrin është të shkatërrosh memorigen, gjurmët e së kaluarës dhe vërtetën, që t'i nuk je më shumë sesa një injorant, por gjysmë injorant", tha ai. Më tej, edhe Vasjan Lami u shpreh se "Apeli im është shumë i thjeshtë, t'i japim fund kësaj loje të shëmtuar. Teatri mund të bëhet shumë mirë aty ku është. Ligji duhet të tërhiqet dhe të hapet një konkurs siç duhet".





**PROTESTUESIT NË LOT, DEPUTETËT DALIN FSHEHURAZI**

Deri në orën 22:30 të mbrëmjes artistë dhe qytetarë kanë qenë në protestë para parlamentit. Kur ligji që shemb teatrin u miratua me votat r mazhorancës artistët shpërthyen në lot. Megjithatë sonte në orën 19:00 do jenë sërish në protestë në teatër. Për shumë protestues, diktatura është kjo: asnjë nga 75 deputetët e PS nuk i doli kundër kreut të partisë. Sesilia Plasari e ardhur nga Franca enkas për protestën tha se nuk duhet të jetë kjo PS. Bert Budina tha se tani duhet radikalizim i qëndrimit pasi nuk ka asnjë reflektim. Protestuesit i pritën deputetët jashtë hyrjes kryesore por ata dolën nga hyrja anësore.



**DEKLARATA**

Unë, për Organizatën e Bashkimeve Profesionale të Mbrojtësve të Licencuar të Teatrit, një pjesë e së cilës i kanë dhënë E.R. votat për të futur në dorë pushtetin, qenkësia "i vonuar" me shkrimet e mia. Kur ish-mikut tim nuk kam ngurruar t'i them atë shprehjen e Konicës, kujtoni se e kam problem t'ju them ndoca teatërmëdhënjve prej jush "Ç'më çani trapin!"?

Reagimi i studiuesit: Një pjesë e juaja i kanë dhënë E.R. votat për të futur në dorë pushtetin

# Plasari: Më qorton për teatrin organizata e bashkimeve profesionale

*"Më 2011 ju thashë që E.R nuk bën për të qeverisur"*

Tri ditë pas një shkri mi të gjatë ku Aurel Plasari jepte argumente shteruese në mbrojtje të Teatrit Kombëtar, "ka kërkuar ndjesë" për shkrimin e tij. Shkak janë bërë kritikant ndaj tij, ku duket se emra të ndryshëm i kanë shkruar për t'i thënë që je i vonuar në shkrimin për teatrin. "U duhet treguar saktë bashkëqytetarëve se për çfarë monumenti shumëfish historik bëhet fjalë, ndonëse betejën për mbrojtjen e tij po e zhvillojnë më së shumti njerëz të teatrit. Ata paçin faqen e bardhë për këtë betejë! Dhe nuk do të m'i keq-uptojnë pohimet e kë-tushme, së paku ata që e dinë se, për ç'i takon historisë së teatrit, jam rritur në rreth familjar njerëzish të lidhur me teatrin qysh prej viteve '30. Por, meqë kazma e sapongritur synon një rrenim shumë më 'kompleks', duhet shtyrë pak dera e së kaluarës për të parë të ardhmen para se krimi të kryhet", shkruante mes të tjerash Plasari. Shtonte se fotot e LUCE-s i dëshmojnë (në teatër) shërbime të një cilësie ende sot të lakmueshme, d.m.th. krejt ndryshe nga sa ankohet ndonjë 'ndërtues' nga ata të specializuarit për të ndërtuar qenefe allaturka të modelit të diktaturës. Për-mendte se aty dhanë koncerte edhe yjet shqiptare të muzikës lirike, që nga Tefta Tashko-Koço dhe Kristaq Antoniu, nga Jorgjia Filçe dhe Marie Kraja etj. Aty dha shfaqje të vetat edhe Grupi Filodramatik i Radio-Tiranës, siç quhej. "Strazivari", "Peshku në det", "Osman Opingaxhiu" të Viktor Eftimiu etj., çfarë do të thotë që aty u shfaqën Mihal Popi, Behije Çela, Xhevat Serezi dhe të tjera figura që do t'i jepnin sharm edhe Teatrit të ardhshëm Kombëtar.



Aurel Plasari

## Atalanta Pasko: Nuk kanë tagër për prishjen dhe zhbërjen e një kompleksi

Edhe vajza e Dhimitër Paskos (Mitrush Kuteli), Atalanta Pasko, ka dalë në mbrojtje të Teatrit Kombëtar. Jo vetëm ka marrë pjesë në protestat e mbajtura në orën 19:00 çdo mbrëmje në sheshin mes dy teatrove, por edhe dje ka qenë e pranishme në protestën para parlamentit që nisi në orën 10:00.

"Po, miq, kështu vërtet ka qenë, pavarësisht se ç'parti kishte ose ka pushtetin dhe ç'parti është në opozitë. Kam qenë (dhe jam) për të mos prishur Piramidën. Sepse kjo punë nuk ka asnjë lidhje me bindje ose tifozllëqe politike", shkruan ajo në profolin e saj në 'Facebook'. Sipas saj, mbrojtja e vragave të pakta, fatkeqësisht, të kulturës sonë materiale duhet të jetë kryedetyrë për çdo qeveri e çdo parti. "Historia nuk bëhet me qindra ose mijëra vite që shfaqen papritur dhe u japin sendeve vlera. Historia bëhet nga vite, muaj e ditë që vijnë një nga një, me kërkesat dhe hallat e tyre dhe



Atalanta Pasko

kërkojnë zgjidhje. Zgjidhja e propozuar nga qeveria dhe bashkia është më e lehta dhe më e keqja, sepse zhdruk çdo shenjë të së djeshmes. Argumentet e renditura aq bukur nga Prof. Aurel Plasari do të ishin të mjaftueshme për të bindur këdo mendjeçelur e të palidhur nga interesa të pashpallura lëndore, rreth vlerave të gjithë atij kompleksi (TRUALL për qeverinë e bashkinë!?)", shkruan e bija e Kutelit. Ajo verën se çësht-

ja duhet t'i shtrohet logjikës, jo listave të aktorëve që kaluakan në listën "për prishje". "Aktorët kanë të drejtë të kërkojnë teatër të ri, por s'kanë tagër të vendosin për prishjen dhe zhbërjen e një kompleksi i cili nuk lidhet vetëm me teatrin! Prandaj, kush e mendon kështu, le t'i shtojë një mundim më shumë ditës e lodhjes së vet e të dalë TE TEATRI", vërente ajo gjatë kësaj jave.

që vijoi të funksiononte si i "kategorisë së parë". Por tek- sa shkrimi u bë viral ai dje ka bërë "autokritikën" e mëposhtme.

**"AUTOKRITIKË"**  
Ky i këtuhami, paskësh

qenë një shkrim imi i gabuar, sepse paskësh qenë i vonuar, jashtë kohe, kur të tjerët e paskëshin realizuar dhe kryer mbrojtjen madhore të Teatrit. U bë e treta herë që e lexoj, tani edhe e dëgjoj me

veshë, sesi po më qortojnë madje edhe gjatë një mbledhjeje të freskët natësore "mbrojtësish të teatrit". e paskështa shkruar më vonësë, jo kur do ta kishte dashur Organizata e Bash-

**MILLEFI**  
Me vonësë unë? I cili kam qysh prej 2011 - e pakta - që kam ngulmuar publikisht (me një listë të mirë shkrimesh) që E.R. nuk bën për të qeverisur? Që E.R. nuk njih as idetë dhe as praktikat demokratike? Që E.R. e urren parlamentarizmin? Që E.R. ushqen mllef kundër inteligjencisë; madje - për ata që e mbajnë mend - e kam ftuar që, nëse ka pasur ndonjë mllef me mua, të vinte e të më lëpinte këpucët.

kimeve Profesionale të Mbrojtësve të Licencuar të Teatrit. A thua se kisha shkruar për ta: i ka gënjer mendja! Me vonësë unë? I cili kam qysh prej 2011 - e pakta - që kam ngulmuar publikisht (me një listë të mirë shkrimesh) që E.R. nuk bën për të qeverisur? Që E.R. nuk njih as idetë dhe as praktikat demokratike? Që E.R. e urren parlamentarizmin? Që E.R. ushqen mllef kundër inteligjencisë; madje - për ata që e mbajnë mend - e kam ftuar që, nëse ka pasur ndonjë mllef me mua, të vinte e të më lëpinte këpucët, simbas shprehjes së Konicës? Tani unë, për

Organizatën e Bashkimeve Profesionale të Mbrojtësve të Licencuar të Teatrit, një pjesë e së cilës i kanë dhënë E.R. votat për të futur në dorë pushtetin, qenkësia "i vonuar" me shkrimet e mia. Kur ish-mikut tim nuk kam ngurruar t'i them atë shprehjen e Konicës, kujtoni se e kam problem t'ju them ndoca teatërmëdhënjve prej jush "Ç'më çani trapin!"?

Ja ku ju po bëj "autokritikë" duke premtuar që do të korrigjohe në rastin më të parë, madje duke filluar qysh në këtë moment me uririm tim për dështimin në protestë veçan të atyre që dalin atje në pH acid në trup, burimin i shumë sëmundjeve të ditura, sepse pH acid shkaktohet pikërisht prej ndjenjave negative: mërisë, urrejtjes, mllefitt, zilisë. Si edhe një mësim për veten për të ruajtur pH-in tim alkalin, të favorizuar nga dashuria me të cilën pata shkruar - kur nuk duhej - edhe këtë shkrim të gabuar.

## GODITJA E KRIMIT REAGIMET

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama iu përgjigj dje në të njëjtin takim "Forca e Ligjit në Veprim - Arritje dhe Sfidat", ambasadorit amerikan, Donald Lu, në lidhje me arrestimin e "Eskobarit" të Ballkanit, Klemend Balili. Ai tha se kapja e këtij personazhi në botën e krimit është domosdoshmëri, por nuk është e lehtë. "Unë e mirëkuptoj shqetësimin që nënvizoi për të disatën herë miku ynë ambasadori lidhur me një nga profilet më të larta të krimit të organizuar dhe pa diskutim që arritja në kapjen e këtij personazhi të botës së krimit është një domosdoshmëri dhe do të jetë një sukses i madh. Por, të mos harrojmë që nuk ishte 40 vjet më parë, vetëm pak vite më parë ky ishte drejtor. Ishte drejtor i lidhur politikisht dhe politikisht i provuar drejtor dhe qaditërisht jo drejtor peshkimi, por drejtor transporti. Sot është në kërkim dhe patjetër që në bashkëpunim me partnerët më herët se vonë ai do të kapet, edhe pse nuk është e lehtë, siç tregojnë edhe shembujt e Amerikës apo Italisë kur bëhet fjalë për profile të tilla", u shpreh kryeministri Edi Rama. Kryeministri tha në fjalën e tij se sulmet ndaj ministrit Xhafaj nga opozita më tepër sesa sulme personale janë për të diskredituar luftën kundër krimit të organizuar në sy të ndërkombëtarëve. "Sot ne jemi frontalisht të vendosur dhe pikërisht pse ne jemi frontalisht të vendosur, shikojmë edhe shfaqje të pabesueshme të bashkëpunimit të politikës me krimin. Ministri i Brendshëm i vu në një sulm që synonte jo goditjen e tij, por diskreditimin e të gjithë luftës kundër krimit të organizuar në sytë e të gjithëve ju që jeni këtu me kufje dhe po më dëgjoni mua që po flas shqip. Se në Shqipëri, shqiptarët nuk mund ta hanë atë lloj teatri, por për këdo që është në një skrinë në Berlin, Hagë, Paris dhe në kryeqytetë të tjera që merr raportin ku shkruhet: Audio përgjime, vëllai i ministrit duke diskutuar asatisë e drogës me trafikantët nuk ka as kohë dhe as dëshirë të marrë vesh si është e vërteta sepse i bie më kollaj të thotë: Ja kjo është Shqipëria", u shpreh kryeministri. Sipas kryeministrit, janë mbi 100 raste kriminelësh, të cilët janë liruar nga burgu në sallat e gjykatave. "Janë mbi 100 raste kriminelësh që janë liruar në sallë nga gjykatësit dhe kanë dalë dhe kanë përsëritur krimin, vrasje, përdhunime dhe grabitje me dhunë si tri kategori që nuk

Kryeministri para ndërkombëtarëve: Nuk ka më individë të paprekshëm

# Rama i përgjigjet LU-së: Arrestimi i Balilit domosdoshmëri, por jo e lehtë

"Mbi 100 raste kriminelësh që janë liruar nga gjykatësit"



### FESTA

Me rastin e përfundimit të mandatit të tyre në Shqipëri, ambasadorët e SHBA dhe të BE, Donald Lu dhe Romana Vlahutin dhanë një pritje në rezidencën e ambasadores së BE. Në ceremoni morën pjesë kryeministri Edi Rama me bashkëshorten e tij, ndërsa mungoi opozita.

Kryeministri Edi Rama dje në takimin "Forca e Ligjit në Veprim - Arritje dhe Sfidat"



Ministri i Brendshëm: Rezultate spektakolare në bashkëpunim me të huajt

## Fatmir Xhafaj: Sulmet e politikës së vjetër ndaj policisë i shërbejnë krimit

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj deklaroi dje se "në pak më tepër se gjashtë muaj, rezultatet e arritura nga Policia e Shtetit janë me të vërtetë inkurajuese, duke goditur disa grupe të rrezikshme kriminale, si dhe duke shenjëstruar dhe goditur gjithashtu, çdo aset ekonomik të paligjshëm të përfutur nga veprimtari i tyre". "Politika ka gjithmonë interes të ngushta në diskutimet dhe debatet që zhvillohen në lidhje me çfarë dhe si e bën punën e saj, Policia e Shtetit, si dhe i vlerëson dhe komenton rezultatet e kësaj pune sipas interesit politik të ditës. Është e vështirë që nga ky lloj debati, i cili për fat të keq degradon në shpifje, në trillime apo sulme të ulëta dhe personale të kuptohet si qëndron puna dhe rezultatet e saj në raport me in-



teresin publik", tha Xhafaj. "Prej kohësh me disa agjencitë të rëndësishme ndërkombëtare si FBI, DEA, EUROPOLI, BKA-në gjermane, MFA-në britanike, GdF italiane, por edhe me disa të tjera, ne kemi zhvilluar dhe jemi duke zhvilluar bashkërisht operacione të rëndësishme, deri edhe hetime të përbashkëta për të goditur grupe të organizuara kriminale, këtu, por edhe jashtë

vendit. Rezultatet e këtyre operacioneve janë spektakolare dhe shumë të vlerësuara edhe prej jush", u shpreh Xhafaj. Duke nënkuptuar opozitën, Xhafaj u shpreh: "Jam sinqerisht shumë i keqardhur kur shikoj që kjo lloj politike e vjetruar jo vetëm nuk e bën këtë gjë, por përkundrazi me një papërgjegjshmëri politike sulmon Policinë e Shtetit e më keq akoma e bën këtë edhe në rastet kur operacionet e kësaj policie të bëra ose të koordinuara me partnerët ndërkombëtarë kanë prodhuar rezultate shumë të mira në luftën kundër krimit të organizuar. Është komplet e papranueshme dhe e pajustifikueshme dhe u shërbejnë interesave të botës së krimit, përcaktimi i Policisë së Shtetit me terma të tilla si "forca e krimit" ose "narko-policia", etj".

mund të marrin pafajësinë në sallën e gjykatës. Ne jemi po ashtu të vetdijshëm se ky nuk është një proces, i cili mund të ndodhë në një hark kohor të shkurtër, por ama është një proces që ka filluar dhe është pa kthim", u shpreh Rama. Sipas tij, "me

vetingun e prokurorëve dhe gjykatësve po vendoset baza për të pasur edhe anën tjetër të medaljes së luftës kundër krimit dhe korrupsionit, garanci. Policia e Shtetit e ka garantuar; duan, s'duan ata që duan ta bëjnë këtë diskutim, qofshin shqiptarë,

qofshin të huaj, që paprekshmëria e individit në Shqipëri nuk ekziston më, që nga shkeljet e vogla deri të shkeljet më të mëdha. Çështja është që sistemi i drejtësisë të garantojë që pandëshkueshmëria nuk ekziston më", tha Rama.

## Vlahutin: Shteti s'mban përgjegjësi për kriminelët me origjinë shqiptare

Ambasadorja e Bashkimit Evropian, Romana Vlahutin deklaroi dje gjatë fjalës në takimin "Forca e Ligjit në Veprim - Arritje dhe Sfidat" se, "dekada mangësish dhe abuzimi nuk mund të ndreqen në një vit a dy. Duhet kohë, por rruga është e qartë dhe ecuria e mirë". "Shqipëria është kthyer në model reformash të guximshme, që janë të nevojshme jo vetëm për integrimin në Bashkimin Evropian, por edhe për përparimin e përgjithshëm të këtij rajoni", u shpreh Vlahutin. Sipas saj, "në këta tetë muaj janë bërë shumë gjëra, qoftë në reduktimin e kultivimit e tregtisë së kanabisit, në arrestimin e grupeve të organizuara kriminale në Shkodër, Durrës, Tiranë, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë, Lezhë, Fier, Berat, Korçë, Kukës. I kemi dëgjuar shifrat. Operacione të suksesshme për identifikimin e ngarkesave të drogës, pastrimin e parave, krimin e organizuar lidhur me pronën, trafikimin e qenieve njerëzore". "Ne duhet të jemi të qartë sot, nuk duhet të ketë frikë dhe krimi i organizuar nuk mund të jetë më i fortë sesa shteti. Kur krimi godet, shteti duhet të godasë edhe më fort", u shpreh Vlahutin. "Shteti shqiptar nuk mban përgjegjësi për kriminelët me origjinë shqiptare, por institucionet e shtetit të së drejtës në Shqipëri e në të gjitha vendet ku ata kryejnë krime janë përgjegjëse për të bërë gjithçka që t'i çojnë ata përpara drejtësisë", theksoi Vlahutin.

## Ruçi pret presidenten e Senatit të Holandës: Ky është viti i 'Po-së' për Shqipërinë

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, priti në një takim presidenten e Senatit të Holandës, Anki Brukers-Knol dhe delegacionin që e shoqëronte, të cilët po zhvillojnë një vizitë zyrtare në Shqipëri. "Ne jemi të bindur se në qëndrimin e Holandës për çështjen e hapjes së negociatave me Shqipërinë nuk ka asnjë grimcë paragjykim, por vetëm vëmendje e kujdes të natyrshëm", nënvizoi Z. Ruçi. "Vërejtjet e Holandës po shqyrtohen me shumë seriozitet nga të gjitha institucionet shqiptare dhe lufta kundër korrupsionit, kriminalitetit dhe trafikëve po ashpërsohet e thellohet", tha më tej, Ruçi. "Deri në qershor 2019 - vuri në dukje Ruçi - Shqipëria do t'i ketë bërë të gjitha detyrat e shtëpisë". Nga ana e saj, presidentja Anki Brukers-Knol theksoi se, "kam ardhur këtu me bindjen se Shqipëria do të bëhet një anëtare solide e Bashkimit Evropian. Holanda është e bindur se Shqipëria është një vend evropian dhe me një të ardhme të qartë evropiane. Qëndrimi i Holandës për çështjen e hapjes së negociatave është një mundësi shumë e mirë për të nxitur Shqipërinë të luftojë më ashpër kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Vetingu është një rast unik dhe rezultatet që ju kemi arritur në këtë aspekt janë impresionuese. Jam e bindur se në qershor 2019 negociatat me Shqipërinë do të hapen. Gjatë këtij viti që kemi përpara Shqipëria do t'i përmbushë të gjitha kushtet", u shpreh znj. Brukers-Knol.





Ambasadori amerikan, thirrje Ramës e Xhafajt: Luftoni pa mëshirë krimin e organizuar

# Donald Lu: Balili me mbështetje politike, policia s'e arrestoi dot

"Kokat e krimit të kenë frikë. Drejtësia po vjen..."

Valentina Madani

Ambasadori amerikan, Donald Lu, për para zyrtarëve më të lartë të vendit, por edhe të BE-së, përçolli dje të tjera mesazhe të forta në adresë të "peshqve të mëdhenj". Ai kërkoi që të futen në burg kokat e krimit në Shqipëri. Diplomati amerikan mori pjesë në konferencën "Forca e Ligjit në Veprim", nga ku siguroi se SHBA-të do të jenë një mbështetje të reformave dhe ngritjes së institucioneve të reja. Por, ambasadori Donald Lu kërkoi edhe njëherë kapjen e "peshqve të mëdhenj", duke e cilësuar dëshmtim të qeverisë moskapjen e Klement Balilit. Zyrtari i lartë tha se ky dëshmtim ka përfshirë të gjitha strukturat ligjzbatuese, ndërsa mori edhe përgjigjen e kryeministrit Rama. Në aktivitetin "Forca e ligjit në veprim" ishin të pranishëm edhe ambasadorë të tjerë të huaj. Ambasadori në ikje i Shteteve të Bashkuara, Donald Lu, fshikulloi qeverinë duke e thënë se ka dështuar në kapjen e shumë të kërkuarit Klement Balili. "Shqipëria mbështeti arrestimin e Met Kananit në Turqi. Banda e tij u arrestua këtu në Shqipëri. Doganat shqiptare zbuluan 630 kg kokainë kolumbiane, që çoi në arrestimin e trafikantit të narkotikëve, Arbën Çekaj në Gjermani. Disa prej anëtarëve të bandës së tij janë arrestuar dhe shpresojmë që ditët e ardhshme të arrestohen të tjerë. Së katërti, kryebashkiaku Fran Frrokaj dhe ish-kryebashkiaku Elvis Roshi po ndiqen penalisht. Emiljano Shullazi dhe Lul Berisha po gjykohej në gjykatë. Hetimi penal kundër ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri dhe ish-Prokurorit të Përgjithshëm, Adriatik Lalla vazhdon. Ka shumë aktivitet për një periudhë të shkurtër kohe, por duam të shohim rezultate konkrete. Duam që 'peshqit e mëdhenj' të ndiqen penalisht, të dënohen dhe futen në burg, ky do të ishte sukses", - deklaroi ambasadori amerikan. Në nëntor të vitit të kaluar, Donald Lu foli me emra konkretë për "peshqit e mëdhenj" që hanë të vegjlit". Në atë kohë, ambasadori ameri-



Ambasadori amerikan, Donald Lu

**DEKLARATA**

"Dëshmtim i prokurorisë, policisë dhe qeverisë për arrestimin e Balilit. Balili është një bos i krimit të organizuar. Nuk kanë pasur aftësinë ose vullnetin për ta kapur. I bëj thirrje Ramës, Xhafajt dhe prokurorëve të vazhdojnë luftën kundër krimit të organizuar pa mëshirë. ONM ka thënë se do përfundojë këtë verë kalimin në veting. Kokat e krimit duhet të kenë frikë. Drejtësia për ta po vjen".

**Pollo citon Wotton:**

Ambasadorët, njerëz të mirë, që gënjëjnë për llogari të qeverive

Deputeti demokrat, Genc Pollo, reagoi dje pas debatëve të fundit mbi qëndrimet e ambasadorëve të huaj në vendin tonë. Ai sjell një shprehje të Henry Wotton, në fillim të shekullit të 17-të, i cili ka thënë se: "Ambasadorët janë njerëz të mirë, të dërguar për të gënjyer për llogari të qeverive të tyre". Por sipas tij, kryeministri Rama e ka ndryshuar këtë shprehje në: "Ambasadorët janë njerëz të mirë që gënjëjnë kryeqytetet e tyre për llogari të qeverisë mikpritëse". "Ambasadorët janë njerëz të mirë, të dërguar për të gënjyer për llogari të qeverive të tyre, - është një shprehje e njohur e një anglezi të famshëm, Henry Wotton, në fillim të shekullit të 17-të. 4 shekuj më vonë, Edi Rama, kryeministri i Shqipërisë, e ka ndryshuar de facto këtë fjalë të urtë: Ambasadorët janë njerëz të mirë që gënjëjnë kryeqytetet e tyre për llogari të qeverisë mikpritëse", shprehet z.Pollo. Më vonë gjatë ditës u zhvillua një festë lamtumire e ambasadorëve të BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin dhe ambasadorit amerikan, Donald Lu. Zyra e deputetit demokrat konfirmoi se kishte refuzuar me mirësjellje ftesën për të marrë pjesë në këtë aktivitet.

**Refuzimi**

Gjatë ditës së djeshme u zhvillua një festë lamtumire e ambasadorëve të BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin dhe ambasadorit amerikan, Donald Lu. Zyra e deputetit demokrat konfirmoi se e kishte refuzuar me mirësjellje ftesën për të marrë pjesë në këtë aktivitet.

**Kreu i PD-së: Rama qeveris bashkë me krimin**

Basha, Lu-së: "Peshqit e mëdhenj" janë në krahët e tuaj në çdo pritje zyrtare

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha iu përgjigj dje nga parlamenti ambasadorit Donald Lu për "peshqit e mëdhenj", duke theksuar se ata janë në podiumin e qeverisë dhe në çdo pritje zyrtare. "Oqean? Mos gënjoni veten tuaj zotëri ambasadorë, se shqiptarët nuk gënjehen më. 'Peshqit e mëdhenj' janë në krahët e tuaj në çdo pritje zyrtare dhe në podiumin e qeverisë këtu në parlament", tha kreu i PD-së.



**REAGIMI**

"Oqean? Mos gënjoni veten tuaj zotëri ambasadorë, se shqiptarët nuk gënjehen më. 'Peshqit e mëdhenj' janë në krahun tuaj në çdo pritje zyrtare dhe në podiumin e qeverisë këtu në parlament", tha kreu i PD-së.

751	RAHMIJE	OSMAN	ÇAKA	
752	NADIRE	OSMAN	ÇAKA	
753	BEDRIJE	OSMAN	ÇAKA	
754	SKENDER	OSMAN	ÇAKA	
755	SHEFIKAT	OSMAN	ÇAKA	
756	HATIXHE	OSMAN	ÇAKA	
757	SHYQYRI	IBRAHIM	ÇAKA	
758	NAXHIJE	IBRAHIM	ÇAKA	3,412,400.20
759	RAZIJE	IBRAHIM	ÇAKA	
760	ARTA	ISMAIL	ÇAKA	
761	FATMA	ISMAIL	ÇAKA	

762	SKENDER		QORRI	
763	MERITA		QORRI	
764	ISMAIL		QORRI	
765	ASTRIT		QORRI	
766	DASHAMIR		QORRI	
767	ZINET		QORRI	
768	MIRANDA		QORRI	
769	NAZMI		QORRI	
770	HAXHIRE		PENI	
771	SUZANA		QORRI	
772	MYZEJEN		QORRI	
773	JALLDYZ		QORRI	3,972,156.80

774	MEHMET	QAZIM	KOÇANI	
775	FATMIRE	QAZIM	KOÇANI	
776	HYSEN		ZYMA	
777	NAZMI		ZYMA	
778	LUMNI		ZYMA	
779	BEDRI		ZYMA	
780	OSMAN		ZYMA	
781	IKBAL		ZYMA	
782	BASHKIM		ZYMA	48,503.20

783	AFRIDA	YMER	BALASHI	
784	BASHKIM	ISMAIL	ARAPI	
785	DEVIS	AGRON	BALASHI	
786	GRETA	AGRON	BALASHI	
787	SULION	AGRON	BALASHI	
788	ARBEN		PEQINI	
789	DASHAMIR		PEQINI	
790	DIANA		ARAPI	
791	FATBARDH		PEQINI	
792	IRIDA		ARAPI	
793	KLAJDI		ARAPI	
794	LIRI		ARAPI	
795	NAIM		PEQINI	
796	PELLUMB		ARAPI	

(vijon)

Autoriteti i Konkurrencës nis hetimin e thelluar për tregun agro-ushqimor

Ornela Manjani

# Çmimet e fruta-perimeve, dyshohet për abuzim me pozitën monopol

## Kompania zotëron 100% të aksioneve të tregut në Tiranë

Autoriteti i Konkurrencës ka vendosur që të kalojë nga hetimi paraprak në një hetim të thelluar lidhur me kompaninë, e cila zotëron 100 përqind të aksioneve të tregut agro-ushqimor në Tiranë. Hetimi i thelluar sipas vendimit të Konkurrencës do të përfshijë periudhën kohore 01.01.2017 deri në 01.05.2018 ndërkohë që raportit përfundimtar duhet të jetë gati brenda këtij muaji. "Referuar analizës së tregut të qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agro-ushqimore në qytetin e Tiranës, rezultoni se sjellja e ndërmarrjes me pozitë dominuese, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese referuar nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", me pasojë për konkurrencën në treg" vlerëson Konkurrenca në vendimin e saj.

### TREGU NËN HETIM

Sipas analizës së Konkurrencës, dhënia me qira e ambienteve, magazinave dhe vendeve me qëllim tregtimin e produkteve agro-ushqimore në qytetin e Tiranës ushtrohet nga ndërmarrja që operon e vetme në këtë treg. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se në këto kushte për tregtarët e shumicës nuk ka një alternativë tjetër për të tregtuar produktet e tyre, si rrjedhojë nuk ka zëvendësueshmëri nga ana e kërkesës. Zona gjeografike e shërbimit të qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin me shumicë të produkteve agro-ushqimore është territori i qytetit të Tiranës, për pasojë tregu përkatës gjeografik në këtë rast përfshin qytetin e Tiranës.

### VLERËSIMI I POZITËS DOMINUESE

Nga hetimi i Autoritetit të Konkurrencës rezultoni se ndërmarrja operon e vetme, pra ka treg të dominuesë për sa i përket pjesëve të tregut. Ajo konsiderohet si një kompani që ka pozitë të konsoliduar ndër vite duke zotëruar edhe 100 përqind të tregut përkatës. "Referuar Udhëzimit Nr. 11, datë 2.7.2014 "Për vendndodhjen dhe kushtet e tjera të tregjeve të shitjes me shumicë" të Ministrit të Bujqësisë dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë Nr.19, datë 09.04.2015 "Për miratimin e kriterëve për vendndodhjen dhe kushtet e tjera të tregjeve të produkteve agro-ushqimore të shitjes me shumicë në Bashkinë e Tiranës kanë shërbyer si barriera hyrëse për ndërmarrjet e interesuara për të operuar në këtë treg. Gjithashtu, pozita e konsoliduar e ndërmarrjes në



treg, qëndrueshmëria e pjesëve të tregut në vite (duke zotëruar 100% të tregut përkatës si e vetmja ndërmarrje), si dhe investimet që duhen për ndërtimin e këtyre tregjeve, përbëjnë barriera të larta në hyrje në tregun përkatës" vlerëson Autoriteti. I njëjti institucion vlerëson se sipas bilancit të ndërmarrjes, vlerës së shitjeve në tregun përkatës, ndërmarrja ka fuqi ekonomike e financiare, e cila mund të shkaktojë kufi-

zime të mundshme të konkurrencës në tregun përkatës. Kanë qenë të gjitha këto të dhëna të mjaftueshme për autoritetin që të vlerësojë se ndërmarrja ka pozitë dominuese në shërbimin e dhënies me qira të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin me shumicë të produkteve agro-ushqimore në qytetin e Tiranës. Në këto kushte është parë e rëndësishme të vlerësohet sesi sillet

### me këtë pozitë kompania. SJELLJA E NDMARRJES NË TREG

Autoriteti i Konkurrencës ka analizuar se nga ana e ndërmarrjes aplikohen tarifa të ndryshme për hapësirat që jep me qira. Kjo në varësi të vendit. Po kështu kontrata parashikon penalitete për qiramarrësit kur ata nuk paguajnë në kohë detyrimin që kanë ndaj kompanisë. Por autoriteti ka konstatuar se ndërsa kontrata garanton sig-

uri për qiradhënesin nuk e mbron qiramarrësin nga prishja e njëanshme e saj. "Në kontratë janë parashikuar garancitë dhe penalitetet e sipërcituara, ndërsa për pjesën e detyrimeve të qiradhënesit nuk parashikohet asnjë formë kompensimi për qiramarrësin. Kontrata nuk parashikon asnjë afat për njoftim të qiramarrësit në rastet kur qiradhënesi prish kontratën dhe e nxjerr qiramarrësin nga tregu, duke vepruar në mënyrë të njëanshme. Zgjidhja e njëanshme e kësaj kontrate nga ana e qiradhënesit e bën të vështirë mbrojtjen e qiramarrësit, duke ndikuar drejtpërdrejt në marrëdhënien dhe kushtet ndërmjet tyre. Sa më sipër, kushtet e përcaktuara në kontratë janë kushte që sigurojnë dhe japin garanci vetëm për qiradhënesin, ndërsa për qiramarrësin nuk jepet asnjë garanci në rast të prishjes së njëanshme të kontratës nga ana e qiradhënesit, ndërmarrjes EKMA Albania SHPK. Kontrata vjen si rezultat i faktit që është i vetmi treg shumicë që operon në Tiranë, duke mos siguruar asnjë mbrojtje për qiramarrësin ndaj asnjë forme abuzimi të mundshëm nga ndërmarrja që zotëron tregun. Për organizimin dhe funksionimin e tregut nuk ka një rregullore të mirëpërcaktuar dhe miratuar, mbi bazën e së cilës të mund të monitorohet sjellja e ndërmarrjes me pozitë dominuese që vepron e vetme në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agro-ushqimore në qytetin e Tiranës. Mbajtja e një pozite dominuese e ngarkon ndërmarrjen me një përgjegjësi të veçantë, për sjelljen e saj, veçanërisht në vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë të çmimeve të padrejta apo të kushteve të tjera të padrejta të tregimit; kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik; zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprimet tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence; vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë" thuhet në vendimin e Konkurrencës.

**Tatimet, bizneseve: Përditësoni të dhënat për t'u përjashtuar nga analiza e riskut**



Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve dhe Tatimeve, fton tatimpaguesit që të bëjnë përditësimin e të dhënave të aktivitetit ekonomik që ushtojnë. "Është e rëndësishme që këto të dhëna të jenë sa më të sakta, pasi vetëm në këtë mënyrë përjashtohet mundësia që të përzgjidheni gabimisht nga analiza e riskut. Administrata Tatimore, përdor analizën e riskut për të identifikuar tatimpaguesit e parregullt, duke i bërë ata në këtë mënyrë objekt të kontrolleve të thelluara tatimore. Kjo shoqërohet me kosto, jo vetëm për administratën, por edhe për vetë tatimpaguesit" njoftojnë Tatimet. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve sjell në vëmendje, se çdo përpjekje për të përmbyshur vullnetarisht detyrimet ligjore, sa i takon deklarimit dhe pagesës në kohën e duhur, i klasifikon tatimpaguesit si të rregullt dhe nuk i bën ata objekt të kontrolleve të thelluara tatimore. Tatimpaguesit, duhet t'i drejtohen Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë përditësimin e aktivitetit të tyre ekonomik.

**Huat me probleme zbresin në 13.3% në maj**

## BSH: Rreth 560 milionë euro të pakthyera në afat

Huat që nuk kthehen në afat në sistemin bankar kanë shënuar rënie në maj, pas një rritjeje të lehtë muajin e mëparshëm. Sipas statistikave të publikuara nga Banka e Shqipërisë treguesi i kredive me probleme arriti në 13.31% të totalit të huas në sistemin bankar, nga 13.46% që kishin arritur muajin e mëparshëm. Megjithatë, në krahasim me fundin e vitit të kaluar, ky tregues ka shënuar një rritje të lehtë. Huat me probleme zbritën në 13.23% të totalit në dhjetor, niveli më i ulët në gati 7 vite. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, gjatë konferencës së djeshme për shtyp tha se "Banka e Shqipërisë gjykon se bilancet e bankave janë drejt shëndoshjes, sikundër

ilustrohet nga rënia në 13.3% e raportit të kredisë me probleme në muajin maj. Po ashtu, rrezik i kredisë në vend vijon të shkojë drejt reduktimit, si pasojë e përmirësimit ciklik të ekonomisë dhe e masave të marra për zgjidhjen e kredive me probleme. Në këto rrethana, sektori bankar duhet të jetë më proaktiv dhe i vëmendshëm në plotësimin e nevojave afatmesme dhe afatgjata të ekonomisë për financim". Në vlerë absolute, huaja që nuk kthehet të paktën prej tre muajsh në banka ishte 71.8 miliardë lekë, ose rreth 560 milionë euro. Në krahasim me muajin e mëparshëm, kemi një rënie të tyre në vlerë absolute, me 1.7 miliardë lekë, ose 2.3%. Ngadalësimi i kreditimit ka ndikuar në mosrënien e dukshme të treguesit në për-

qindje, ndonëse në vlerë absolute ai është në rënie. Sipas statistikave të Bankës, në fund të majit stoku i huas në total për ekonominë ishte 539.5 miliardë lekë, duke u tkurrur me 6.5 miliardë lekë, ose 1.2% në krahasim me muajin e mëparshëm. Në krahasim me gjysmën e dytë të vitit 2014, kur huat me probleme arritën në rreth 25% të totalit, niveli i tyre ka rënë dukshëm dy vitet e fundit. Fshirja e huave që kanë më shumë se tre vjet që nuk kthehen nga bilancet e bankare, rstrukturimi i huave (zgjatja e afatit, falja e një pjesë të borxhit me kusht kthimin e pjesës tjetër etj) dhe kujdesi i shtuar i bankave për kreditdhënien e re vlerësohet se kanë ndikuar në përmirësimin e këtij treguesi.



Ina Allkanjari

Fitoi 5 mln lekë nga bastet, "ngec" në rrjetën e vetingut.

# Shkarkohet prokurori i Apelit Luan Kaloçi, KPK: Deklarime kontradiktore

## Probleme me pasurinë, nga lotaria te kreditë

Vetingu skualifikoi ditën e djeshme nga radhët e sistemit të drejtësisë, Prokurorinë e Apelit të Tiranës Luan Kaloçi. Vendimi për shkarkimin e tij u mor pas një hetimi administrativ disa mujor dhe zhvillimit të seancës dëgjimore publike. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi i ndërprese karrierën e prokurorit, me arsyetimin se ai nuk justifikon pasurinë. Gjatë seancës dëgjimore Kaloçi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit. Sipas Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, pasuria e Luan Kaloçit rezultoi me probleme. Trupa e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit e përbërë nga Xhensila Pine, Valbona Sanxhaktari dhe Etda Ciftja u shprehën se nga verifikimi i ILDKPKI dhe i vetë komisionit rezultonte me burime kontradiktore të pasurisë. Në seancë dëgjimore publike, Shehu u njoh me rezultatet e hetimit në të tria shtyllat e procesit të rivlerësimit; pasuria, figura morale dhe aftësitë profesionale. Në seancën e rivlerësimit, relatorja e çështjes tha se: ILDKPKI thotë se subjekti ka kryer deklarim të rremë të pasurisë dhe ka fshehur pasurinë. KPK ka zhvilluar hetimin e tij pas raportit të ILDKPKI. "Nga hetimi rezultoi se subjekti ka një shtëpi 145 metra katrorë, me vlerë 52 mijë dollarë, e në deklaratë ka mospërfutur sa i përket vlerës së apartamentit. Dyqani është blerë në vitin 2003, ndërsa burimi sipas prokurorit është shitja e shtëpisë në Elbasan.



Dyqani ka një sipërfaqe prej 132 m2. E pikërisht për këtë pronë ka mospërfutur mes shifrave të deklaruara. Në vitin 2003 deklarohet si burim, fitimet në baste dhe dy hua. Ndërsa në 2017-ën deklarohet si burim, shitja e banesës në Elbasan. Në vitin 2003, prokurori thotë se i ka fituar paratë në një kompani bastesh. Ndërsa në deklaratën e dorëzuar për efekt të vetingut

nuk e përmend këtë. Shuma e fituar në baste është 5.2 mln lekë. Nga hetimi ynë rezultoi se s'kanë deklaruar në 2007, 5 mijë dollarë dhe 20 mijë euro në emër të gruas. Në 2009-ën ka fshehur 5 mijë euro. Nuk ka deklaruar blerjen e një makine në 2015 dhe që e kishte në emër të vajzës e më pas e ka shitur", u shpreh KPK. Prokurori Kaloçi u pyet nga

vëzhguesi ndërkombëtar për marrëveshjen fiktive për shtëpinë dhe ai e pranoi që në atë kohë kishte informallet dhe ishte i zakonshëm. "Në atë periudhë, këto gjëra kanë ndodhur. Ka pasur informallet, i cili ishte i papërshtatshëm", u shpreh prokurori. Ndërkohë sipas raportit të prodhuar nga BIRN tregohet se prokurori i Apelit, Luan Kaloçi zotëronte pasuri me vlerë 10 milionë lekë në vitin 2003-kur deklaroi pasurinë e tij për herë të parë. Sipas deklaratës së vitit 2003, prokurori Kaloçi zotëronte një apartament banimi në Tiranë të blerë në vitin 2000 për 4.2 milionë lekë si dhe një dyqan me vlerë 5.8 milionë lekë që ka si burim të deklaruar bastet sportive. Në fund të vitit 2017, pasuria familjare e zotit Kaloçi është rritur me 2.4 herë me një vlerë totale prej 24.3 milionë lekësh. Kujtojmë se Kaloçi ishte kandidat edhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

### Vetingu, KPK konfirmon në detyrë gjyqtaren e Tiranës, Alma Brati

Gjyqtarja Alma Brati do të vijojë detyrën e saj pasi ka kaluar me sukses procesin e vetingut. Vendimi është dhënë ditën e djeshme nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Trupa e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit e përbërë nga Pamela Qiko dhe Lulzim Hamitaj vlerësoi pozitivisht tre shtyllat e rivlerësimit atë të pasurisë, aftësitë profesionale t, trupa gjyqese vendosi konfirmimin në detyrë të zonjës Alma Brati", tha relatorja Pamela Qirko. Në raportin e ILDKPKI-së, thuhet se Brati nuk ka fshehur pasurinë, dhe nuk është në konflikt interesi. Pasuritë e Alma Bratit janë një apartament banimi 101 metra katrorë, blerë në kontratë shitjeje me rezervë 80 mijë euro, për të cilin ka shërbyer kontrata e kreditës 50 mijë euro. Deri në vitin 2016 detyrimi ishte 6 mln, ndërsa nga tezja e saj kishte një hua prej 25 mijë eurosh. Shtëpinë e dytë e kishte një hua prej 179 metra katrorë, me kontratë shitjeje në vitin 2002, blerë për 1.9 milionë lekë në bashkëpronësi me ish-bashkëshortin dhe prindërit. Në pasurinë e saj rezultoi edhe një makinë "Mazda" me vlerë 19.500 euro. Brati u vetua me përparsi për shkak të kandidimit në Këshillin e Lartë Gjyqësor.



## Akademia e Biznesit të ALBtelecom diplomon brezin e katërt të studentëve

Universiteti Politeknik dhe ALBtelecom nënshkruajnë një Memorandum Mirëkuptimi për një bashkëpunim strategjik të mëtejshëm me Akademitë ALBtelecom

ALBtelecom vijon mbështetjen e brezit të ri të studentëve në fushën e biznesit dhe teknologjisë përmes Akademisë së Biznesit dhe asaj të Teknologjisë, duke kombinuar teorinë dhe praktikën si një mundësi e shkëlqyer për studentët më të spikatur në këto fusha.

Gjatë ceremonisë së diplomimit, zhvilluar në zyrat qendrore të kompanisë, u festua përfundimi me sukses i studimeve të Akademisë së Biznesit 4 dhe Akademisë së Teknologjisë 3.

Akademia e Biznesit ALBtelecom është një program studimesh i ideuar për të zhvilluar më tej aftësitë menaxhuese të punonjësve, duke i përgatitur ata si liderë të së ardhmes. Trajnimit e zhvilluar në Akademinë e Teknologjisë dhe atë të Biznesit, përgjatë rrugëtimit të tyre kanë mirëpritur studentët ekselentë të Universitetit Politeknik të Tiranës, pjesë e programit "SUPER Generation" si edhe punonjës të kompanisë. Studentët pjesëmarrës të dy akademive morën njohuri mbi teknologjinë e përdorur në ALBtelecom, risitë në fushën e telekomunikacionit si dhe



trendet e fundit të menaxhimit dhe drejtimit. Pas tre vitesh historiku suksesi të zhvillimit të Akademisë së Teknologjisë, ALBtelecom vetëm në këtë akademi ka diplomuar 120 studentë.

Në ceremoninë e diplomimit ishin të pranishëm zv. Ministri i Infrastrukturas dhe Energjisë, Znj. Dorina Çinari, Drejtori i Përgjithshëm i kompanisë ALBtelecom Z. Tahsin Yilmaz, Kryetari i Bordit të kësaj kompanie Z. Hydajet Kopani, Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës, Z. Andrea Maliqari, lektorë e studentë të Akademisë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari i Bordit, Z. Hydajet Kopani



Z. Tahsin Yilmaz CEO i ALBtelecom dhe Z. Andrea Maliqari Rektori i UPT

përgëzoi të diplomuarit e akademisë për përfundimin me sukses të programit, duke vënë theksin në projektet e ndërmarrja nga ALBtelecom për zhvillimin e burimeve njerëzore: "Mjedisi tepër konkurrues ku ALBtelecom operon është një nxitje e fortë për të punuar edhe më shumë për të përparuar në fushën e ofrimit të shërbimeve dhe teknologjisë; për të bashkëpunuar me projektet e qeverisë sa i takon digitalizimit; për të bashkëpunuar me të gjithë palët e interesuara për zhvillimin e vendit, si dhe për të shtuar vlerë vetë kompanisë ALBtelecom" - tha Z. Kopani gjatë ceremonisë së diplomimit.

Zv. Ministri i Infrastrukturas dhe Energjisë, Znj. Dorina Çinari vlerësoi bashkëpunimin e ALBtelecom me institucionet shtetërore dhe biznesin privat si dhe kontributin e kësaj kompanie në përmirësimin e zhvillimit teknologjik dhe ofrimin e risive për të ardhmen e Shqipërisë.

Znj. Çinari në fjalën e saj theksoi se: "Tashmë aftësitë digjitale kërkohen në çdo fushë. Edhe për këtë arsye Akademia e Teknologjisë ALBtelecom është një mundësi e jashtëzakonshme që iu jepet studentëve dhe është ambienti brilant ku atyre po u mundësohet të lundrojnë në botën digjitale dhe ku po u mësohet të

përgatien me të gjitha aftësitë, për të konkurruar siç duhet në ekonominë e tregut."

Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës, Z. Andrea Maliqari shprehu kënaqësinë e tij të veçantë që studentët e Universitetit të cilin ai drejton u bënë pjesë e kësaj Akademie me shumë vlera për studentët dhe vetë Universitetin. Marrëdhëniet e bashkëpunimit me ALBtelecom dhe Universitetit Politeknik kulmuan edhe me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit midis kompanisë ALBtelecom dhe Universitetit Politeknik të Tiranës. Ky memorandum synon intensifikimin e bashkëpunimit dhe ofrimin e mundësive për studentët e universitetit, të cilët do të bëhen pjesë e kurikulave të Akademive ALBtelecom. Gjithashtu, ALBtelecom ofron fushën e ekspertizës, mbështetjen me ambientet e veta dhe bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës në punë kërkimore dhe projekte lidhur me fushat përkatëse të studimit.

Në përfundim të ceremonisë studentët e diplomuar si edhe punonjësit e ALBtelecom festuan nën tingujt e këngëve të Aleksandër Gjokës në një koncert dhe atmosferë festive, të përgatitur posaçërisht për këtë Super ditë në SUPER Stacionin e ALBtelecom.

Kujdes, vetëm pas aprovimit nga universiteti mund të aplikoni për vizën F1

# Studimet në Amerikë, pesë hapat kryesorë për t'u shpallur fitues

## Ambasada: Ja kategoritë që mund të përfitojnë bursa

Voltiza Duro

Studentët që janë të interesuar të ndjekin një prej programeve të studimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, tashmë mund të njihen me procedurat kryesore të aplikimit për t'u shpallur fitues. Ditën e djeshme, ambasada amerikane në Tiranë ka bërë një njoftim të rëndësishëm për të gjithë të interesuarit e më tej ka sqaruar kandidatët mbi 5 hapat që duhet të ndjekin. "Para se të aplikojnë për një vizë, të gjithë aplikantët për vizë studentore duhet të pranohen dhe aprovohen për programin e tyre. Pas pranimit tuaj, institucionet arsimore dhe sponsorët e programit do t'ju japin dokumentacionin e nevojshëm të aprovimit, të cilin ju duhet ta paraqisni kur të aplikoni për një vizë", theksojnë ekspertët e ambasadës.

### KRITERET DHE APLIKIMI

Të interesuarit që dëshirojnë të studiojnë në Shtetet e Bashkuara duhet të dinë se nuk ka kriter moshë për t'u pranuar. Për sa i përket kriterëve, është në varësi të universitetit. Megjithatë studentët duhet të bëjnë kujdes me formularin e aplikimit, tarifën e aplikimit (nëse ka), provimet e TOEFL dhe SAT, letra rekomandimi, eseja, aktivitetet jashtëshkollore, vërtetimi bankar. Provimi i TOEFL është provimi që mat nivelin e gjuhës angleze, ndërsa SAT janë provim mbi matematikën dhe gjuhën angleze. Ndryshe nga Shqipëria, ku çdo procedurë regjistrimesh në universitet është e rregulluar nga Ministria e Arsimit dhe është njësoj për të gjithë universitetet, në Amerikë, universitetet janë më të pavarura për sa i përket kriterëve të pranimit që vendosin dhe data e aplikimit. Kjo do të thotë që secili universitet në Amerikë ka kriteret e



veta të pranimit dhe afatet e veta të aplikimit. Të gjithë që përbushin këto kriteret të aplikimit mund të aplikojnë në universitete. Instrukturët e Qendrës Informative të Arsimit Amerikan në Shqipëri i orientojnë dhe qartësojnë aplikantët, që të ndjekin në mënyrë vijuese hapat e duhur.

**HAPAT KRYESORË**

Education USA e ka thjeshtësuar gjithë procesin duke e përmbledhur në pesë hapa. Hapi i parë është gjetja e universitetit. Në Amerikë ka mbi 4,500 institucione të arsimit të lartë, që ndahen në kolegje 2 vjeçare, universitete dhe kolegje 4

vjeçare. Hapi i dytë është financimi i studimeve. Studentët shqiptarë mund të aplikojnë për bursa të plotë dhe bursa të pjesshme. Hapi i tretë është procesi i aplikimit. "Në momentin që dokumentet i keni gati mund të bëni aplikimin me postë ose elektronik në varësi të kërkesës së universitetit. Hapi i katërt është aplikimi për vizë. Në momentin, që vjen dokumenti i pranimit nga universiteti mund të aplikoni për vizën studentore F1. Hapi i pestë është takimi para nisjes në Amerikë", bëjnë me dije ekspertët. Të interesuarit mund të aplikojnë për të

gjitha degët, madje edhe ato programe që në Shqipëri ende nuk ka. Drejtësia dhe mjekësia janë dy nga degët që kanë një rrugëtim ndryshe nga Shqipëria. Ndërkohë, shumë universitete lejojnë edhe studimin e dy degëve njëkohësisht, në mënyrë që studentit të jetë më i kompletuar për tregun e punës. Zakonisht tarifa totale e studimit përbëhet nga taksa e shkollës dhe nga shpenzimet e jetesës. Një pjesë e financimit mund të jetë edhe ndërmjet bursave. Bursat ndahen në bursa merite dhe bursa nevojë. Bursa e meritës i akordohet studentëve të shkëlqyer si në rezultatet e gjimnazit edhe në provimet e TOEFL dhe SAT. Gjithashtu, çdo dokument i dosjes së aplikimit do të vlerësohet për të arritur në vendimin nëse e meriton bursën e meritës. Ka, gjithashtu, universitete që ofrojnë bursa nevojë për studentët ndërkombëtarë.

### 5 HAPAT E APLIKIMIT PËR STUDIME NË SHBA:

1. Shqyrto alternativën më të mirë për arsimin Hapi i parë është gjetja e universitetit. Në Amerikë ka mbi 4,500 institucione të arsimit të lartë, që ndahen në kolegje 2 vjeçare, universitete dhe kolegje 4 vjeçare.
2. Përfundo dokumentacionin për aplikim Hapi i dytë është financimi i studimeve. Studentët shqiptarë mund të aplikojnë për bursa të plota dhe bursa të pjesshme.
3. Financo studimet, duke aplikuar për bursë Hapi i tretë është procesi i aplikimit. Në momentin që dokumentet i keni gati mund të bëni aplikimin me postë ose elektronik në varësi të kërkesës së universitetit.
4. Apliko për vizë student Hapi i katërt është aplikimi për vizë. Në momentin, që vjen dokumenti i pranimit nga universiteti mund të aplikoni për vizën studentore F1.
5. Përgatit udhëtimin për në USA Hapi i pestë është takimi para nisjes në Amerikë

### Reduktimi i riskut ndaj fatkeqësive, 7 vende të rajonit kopjojnë Kroacinë

## Haki Çako: Kemi nxjerrë mësim nga dimri i këtij viti, gati për situatën e zjarreve

7 vende të rajonit do të kopjojnë nga modeli kroat për përballimin e fatkeqësive natyrore, përmbytyje, rënie zjarri apo reshje të mëdha bore. Në një tryezë të rrumbullakët, në kuadër të projektit rajonal "Ngritja e rrejtjet të veprimtari për forcimin e aftësive ripërtëritëse Urbane nga Fatkeqësitë në Evropën Juglindore (SEE Urban)", Haki Çako, Drejtor i Emergjencave Civile tha: "Projekti aktual është në kohën e duhur, pasi nëpërmjet përvojës së Kroacisë apo edhe shteteve të tjera të rajonit, ai po jep kontributin e tij, ndër të tjera, edhe në implementimin e Sendait në nivelin lokal. Është i do-



mosdoshëm ndryshimi i përjasjes së bashkive dhe prefekturave në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, duke pasur parasysh përvojën dhe mësimet e nxjerra nga menaxhimi i përbashkët i katër fatkeqësive të dimrit të jashtëzakonshëm të këtij viti; tre përmbytyje dhe situatës së krijuar nga dëbora

e rëndë. Kjo bëhet edhe më emergjente sot kur kemi në prag të periudhës së zjarreve në pyje dhe duhet të mobilizohemi të gjithë për gjatë dimrit dhe përballimin dhe përballimin me sukses të tyre". Vladimir Malkaj, Officer i Programeve të qeverisjes vendore pranë UNDP, theksoi se: "dija dhe shkëmbimi i ideve dhe përvojave të mira, mirë-organizimi për parandalim dhe reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë, ndërtimi i një sistemi bashkëpunimi horizontal midis qeverive vendore dhe shoqatave të tyre, por dhe me homologët e tyre në rajon, janë vlera dhe mundësi që duhen shfrytëzuar dhe që në rastin konkret promovohen nga projekti SEE Urban". Më pas Drejtuesi Teknik i Projektit, nga zyra Rajonale e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - PNUD, Z. Krnoslav Katiç, prezantoi objektivat dhe arritjet e deritanishme të projektit për secilin nga vendet e rajonit.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje programesh Software për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 3.581.600 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje programesh Software për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 01 Gusht 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

### Shitje me Ankad të Pare nga Studio Perbarimore L.D.C

"Trulli - ndërtesë", me nr pasurie 31/12, ZK 3428, vol 5, fq 3 me sipërfaqe totale trualli 1.837 m2 dhe sipërfaqe ndërtese 260.6 m2 me adresë fshati Shtoj i Ri, Shkodër. Regjistruar në Z.V.R.P.P Shkodër në emër të Zako Spaso Ajković. Çmimi fillestar për shitje është 22.400.000 Lekë.

Data e shpalljes 21.06.2018  
Data e zhvillimit 13.07.2018 deri në orën 16.00

Ankandë zhvillohet në ambientet e Studios Perbarimore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.



## LIGJI PËR TË RINJTË

### INTERVISTA

Rrjeti Kombëtar i të Rinjve të Shqipërisë: Të bëhet nxitja e punësimit dhe studimi i tregut

# Ervjola Osmanaj: Vetëm 0.01% e buxhetit të shtetit, për nevojat e të rinjve

"Kërkojmë hartimin e një ligji të posaçëm"

Voltiza Duro

Për dhjetorit të 2016-ës, të rinjtë në vendin tonë kërkojnë hartimin e një ligji për mbrojtjen e të drejtave të tyre, rregullimin e problematikave sociale që hasin si dhe për nxitjen e punësimit. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Ervjola Osmanaj, presidente e Rrjetit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri tregon të gjitha dobitë që do të sjellë ky ligj për personat e moshës 14-29 vjeç. Ajo thekson se futja në fuqi e ligjit për të rinjtë do të nxitë punësimin në radhët e tyre, do të studiojë më mirë tregun e punës dhe do të bëjë të mundur funksionimin e zyrave të këshillimit të karrierës në universitete. Osmanaj bën me dije se për vitin 2018-2019 është atribuar një buxhet prej 0.01% nga buxheti i shtetit për të rinjtë, pra 48 milionë lekë të reja, e si pasojë ajo thekson se ligji për të rinjtë do të kërkojë ndarjen e buxhetit të dedikuar për këtë kategori. Projektligji parashikon gjithashtu edhe shpërndarjen e bursave të studimit për të gjithë ata që nuk kanë mundësi të shkollohen.

**Cili është misioni i Rrjetit Kombëtar të të Rinjve të Shqipërisë dhe në cilat pika është fokusuar aktualisht kjo organizatë?**

Aktualisht, Rrjeti Kombëtar i të Rinjve të Shqipërisë është përqendruar në dy prioritetet kryesore, që kanë të bëjnë me kartën rinore dhe së fundmi po udhëheqim procesin për hartimin e ligjit për të rinjtë në vendin tonë.

**Aktualisht në Shqipëri nuk ka një ligj për të rinjtë. Pse mendoni se nevojitet një ligj i tillë?**

Nga takimet që kemi pasur me të rinjtë kemi arritur në konkluzionin që është i domosdoshëm një ligj për të rinjtë në Shqipëri. Ky ligj do të shërbejë si një mekanizëm shumë i mirë për të rregulluar të gjitha problematikat sociale të të rinjve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Gjithashtu, ligji do të krijojë hapësira që të rinjtë jo vetëm të shprehin nevojat që kanë, por të shprehin talentet, të zhvillojnë aktivitetet e t'u ofrohet më shumë mundësi për t'u fuqizuar. Vlen të theksoj se ligji ka për synim krijimin e kushteve për mbështetjen e të rinjve



Ervjola Osmanaj, presidente e Rrjetit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri

#### NXITJA E PUNËSIMIT

Nxitja e punësimit të të rinjve është një nga shtyllat kryesore të këtij ligji. Ajo çka është kërkuar edhe në takimet konsultuese që kemi zhvilluar është që të ketë një studim të tregut të punës. Ne kemi pafund juristë e ekonomistë që diplomohen, por nuk e dimë akoma nëse tregu shqiptar ka nevojë për kaq shumë vende pune apo jo. Gjithashtu, është kërkuar që zyrat e këshillimit të karrierës në universitete të jenë funksionale, pasi aktualisht nuk funksionojnë.

në vetorganizimin social, zhvillimin dhe përmirësimin e potencialit të tyre. Gjithashtu, synojmë që të realizohet edukimi joformal i të rinjve të vendit tonë. Ne synojmë që me hartimin e një ligji të tillë, çështjet rinore të jenë prioritare në axhendat politike.

Nga takimet konsultuese, cila është grupmosha e të rinjve që parashikohet të përfitojnë nga ky ligj?

Bazuar në kërkesat e të rinjve, kemi menduar që nga ky ligj të përfitojnë të gjithë personat e moshës 14-29 vjeç. Gjithashtu, çdo gjë që kanë nevojë të rinjtë, shërbime, mundësi, mbështetje do të përcaktohen me ligj.

**Kur është parashtruar**

#### KËRKESA E PARË HARTIMIN E KËTIJ LIGJI?

Kërkesa për të pasur një ligj për të rinjtë në vendin tonë është parashtruar që prej dhjetorit të vitit 2016-të, përmes një rezolutes për të rinjtë në Kuvendin e Shqipërisë. Një nga pikat kryesore të rezolutës ka qenë edhe hartimi i këtij ligji. Më tej, në 2017-ën, përmes kontratës rinore kombëtare, e kemi kërkuar me zë të lartë sërish hartimin e këtij ligji, edhe pas kërkesave të shumta të të rinjve në 12 qarqe të vendit. Në tetor të 2017-ës, ne kemi bërë takimin e parë konsultues gjithëpërfshirës me të rinjtë. Takimi i dytë konsultues është zhvilluar në 27 qershor të këtij viti, ku ftuam edhe

përfaqësues të MASR, ku mori pjesë zv.ministri Shpati Kolgega.

**Cilat janë disa nga nevojat e të rinjve shqiptarë?**

Të rinjtë kanë problematika përsa u përket shërbimeve, prandaj kemi kërkuar me zë të lartë kartën rinore, pasi përmban të gjitha shërbimet që të rinjtë kanë nevojë dhe ofrohen me kosto të reduktuara apo edhe falas. Në kushte të tilla, ku të rinjtë kanë pak mundësi që të studiojnë e të gjejnë një punë me kohë të pjesshme sa për të përballuar jetesën, ajo kartë do të ishte shumë funksionale. Të rinjtë sot, sidomos nëpër qytete, nuk kanë qendra rinore, nuk kanë asnjë lloj mënyre për të kaluar kohën e lirë, përveç kafeve dhe lotove që janë shtuar shumë (janë shprehur si problematika nga të rinjtë). Gjithashtu, të rinjtë kanë probleme në shkollë me infrastrukturën. Ky ligj do të ketë ndikimin e tij edhe në arsim. Gjithashtu, ka shumë të rinj sot që nuk ndjekin dot arsimin e lartë, pasi nuk kanë mundësi ekonomike dhe ky ligj parashikon që të jepen sa më shumë bursa

“

Të rinjtë kanë kërkuar që buxheti të jetë i ndarë në nivel qendror dhe lokal. Për vitin 2018-2019 kemi një buxhet prej 0.01% nga buxheti i shtetit për të rinjtë, pra 48 milionë lekë. Çfarë mund të bëhet me kaq për një vit? Asgjë!

studimi.

**A parashikon ky ligj nxitjen e punësimit të të rinjve?**

Natyrisht që po! Nxitja e punësimit të të rinjve është një nga shtyllat kryesore të këtij ligji. Ajo çka është kërkuar edhe në takimet konsultuese që kemi zhvilluar është që të ketë një studim të tregut të punës. Ne kemi pafund juristë e ekonomistë që diplomohen, por nuk e dimë akoma nëse tregu shqiptar ka nevojë për kaq shumë vende pune apo jo. Gjithashtu, është kërkuar që zyrat e këshillimit të karrierës në universitete të jenë funksionale, pasi aktualisht nuk funksionojnë. Studentët ende nuk e dimë se cilat janë degët që mund t'i ofrojnë një punësim të sigurt pas studimeve. Është kërkuar që të vendosen kuota të punësimit rinor, pra të ketë kuota për të rinjtë. Nëse ligji i Vullnetarizmit do të zbatohet, edhe puna vullnetare e të rinjve do të njihet si eksperiencë pune.

**Sa është fondi që është vënë në dispozicion të**

nevojave të të rinjve këtë vit dhe a është i mjaftueshëm?

Të rinjtë kanë kërkuar që buxheti të jetë i ndarë në nivel qendror dhe lokal. Për vitin 2018-2019 kemi një buxhet prej 0.01% nga buxheti i shtetit për të rinjtë, pra 48 milionë lekë. Çfarë mund të bëhet me kaq për një vit? Asgjë!

**Cilat janë pikat ku duhet të mbështetet ligji për të qenë funksional dhe në dobi të të rinjve?**

Ligji paraqet nevojën e themelimit të Këshillit Rinor Kombëtar, i cili do të jetë i instaluar brenda qeverisë dhe i përfaqësuar nga të rinjtë deri në 30 vjeç. U sugjerua që kjo strukturë të jetë e vendosur në atë ministri që do të marrë përsipër të jetë iniciuesja e hartimit të ligjit. Gjithashtu, ligji sanksionon një bazë financiare për mbështetjen e organizatave apo iniciativave rinore, pra e detyron qeverinë që të alokojë një fond të posaçëm nga buxheti i shtetit për mbështetjen rinore që duhet t'u jepet edhe të rinjve që kanë ide inovative. Gjithashtu, të rinjtë kanë kërkuar që ligji të shtrihet edhe në nivel lokal, pra të gjitha bashkitë të kenë një drejtori rinie, si ajo që kemi në Bashkinë e Tiranës. Dhe bashkitë duhet të kenë plane veprimi sesi do të procedojnë me të rinjtë e qytetit.

**Ky projektligj a është hartuar mbi bazën e një ligji që funksionon në një tjetër shtet? A është ndjekur një shembull nga ana juaj?**

Shpeshherë në media u pasqyrua sikur ne po eчим shembullin e Serbisë, por u mor si shembull thjesht për të ilustruar se çfarë duhet të përmbajë një ligj për të rinjtë, pra vetëm për orientim. Shqipëria duhet të krijojë një ligj që t'i përshtrahet kontekstit shqiptar e nevojave që kanë të rinjtë shqiptarë.

Platforma "SME Albania" zhvillon edicionin e dytë të Akademisë Verore për Biznesin

# Nean Muçaj: Ndërkombëtarizimi, suksesi i ekonomisë shqiptare

"Interes i lartë nga ana e studentëve të ekonomikut".



Voltiza Duro

Të gjithë ata studentë apo sipërmarrës që kanë dashur të trajnohen mbi menaxhimin e eksporteve e mbi fushën e tregtisë ndërkombëtare, kanë pasur mundësi të marrin njohuri të thelluara gjatë edicionit të dytë të akademisë verore për SME. Kjo e fundit është një platformë ndërkombëtare, që operon edhe në vendin tonë e ka si synim fuqizimin e sipërmarrësve si dhe jep informacione të vlefshme të studentëve të kësaj fushë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Nean Muçaj, i cili ka përfunduar studimet master për të Drejtën Private dhe të Biznesit, njëkohësisht pjesë e stafit organizativ të "SME Albania", Instituti Shqiptar i SME-ve tregon mbi temat e trajtuara dhe dobitë që ato sjellin për sipërmarrësit. Gjithashtu, Muçaj bën me dije se interesi nga ana e studentëve ishte i lartë, veçanërisht për ata që do të dëshironin një vend pune në sektorin privat. Në fund të trajnimit, pjesëmarrësit u pajisën me një certifikatë si dhe u ofrua një bursë për pjesëmarrje në një trajnim 1-mujor në Akademinë për Biznesin Ndërkombëtar (AIBO) në Pekin në Kinë.

**Cili është misioni i platformës "SME ALBANIA"?**

"SME Albania" është një platformë e ngritur me qëllim fuqizimin e sipërmarrësve në një ekonomi konkurruese. Ofron një platformë edukimi dhe trajnimit, që furnizon me njohuri e informacione dhe mbështet sipërmarrësit në arritjen e sukseseve në aktivitetet e tyre.

**Disa ditë më parë është zhvilluar edicioni i dytë i akademisë verore për SME. Cili është qëllimi i organizimit të këtij edicioni?**

"SME Summer Academy", pra akademia verore për SME është edicioni i dytë që zhvillohet në Shqipëri, në bashkëpunim me "SME Academy Network", në Suedi. Qëllimi i programit të trajnimit ishte ofrimi i njohurive për menaxhimin e eksporteve tek SME-të që dëshirojnë të specializohen në fushën e tregtisë ndërkombëtare.

**Cilat janë disa prej temave kryesore që u trajtohen në "SME Summer Academy"?**

Temat që u trajtohen ishin të shumta. Po përmend disa prej tyre: Guerrilla Marketing për biznesin e vogël dhe networking si një strategji marketingu, nga Z.Keneth OE Sundin,



Nean Muçaj, pjesë e stafit organizativ të "SME Albania", Instituti Shqiptar i SME



Gjatë trajnimit nga "SME Albania"

## INTERESI I STUDENTEVE

Absolutisht që interesi nga ana e studentëve ishte i lartë. Madje, në çdo kohë interes ka nga studentët që bëjnë kërkime në fushat e tregtisë ndërkombëtare dhe hulumtimit të tregut, apo edhe ata që do të dëshironin një vend pune në sektorin privat, trajnime të këtij lloji dhe niveli janë tepër të nevojshme dhe me interes. Pjesëmarrësit u pajisën me një certifikatë. Gjithashtu, u ofrua një bursë për pjesëmarrje në një trajnim 1-mujor në Akademinë për Biznesin Ndërkombëtar (AIBO) në Pekin në Kinë.

thelmuar i "SME Academy Netëorok"; menaxhimi i zinxhirit të furnizimit, nga Z.Daniel Guçe, ekspert për aftësitë e SME-ve, drejtor i programit të SASME 2018. Gjithashtu, u diskutua edhe për programet Interreg IPA 2014-2020, nga Z.Gentian Xhaxhiu, Departamenti i Fondeve të BE-së, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme si dhe bashkëpunimi tregtar Shqipëri-Kinë, nga z.Lian Gang, këshilltar ekonomik e Tregtar, Ambasada e Kinës në Shqipëri. Më tej u fol edhe për hyrjen në strategjinë dhe planifikimin e eksportit, nga Z.Alex Silvestri, konsulent dhe ekspert i Zhvillimit të SME-ve, Universiteti Sussex, Britani e Madhe di dhe për marrëveshjet tregtare shqiptare: CEFTA, EFTA, BE etj., nga Znj.Anxhela Bushati, përgjegjëse e sektorit të menaxhimit të programeve të Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Vlen të theksoj se u disku-

tua edhe mbi ligjin e Procedurave Doganore në Shqipëri, nga Z.Drilon Bushati. Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

**Sa ishte numri i studentëve pjesëmarrës në këtë edicion dhe a pati interes nga përfaqësues të bizneseve mbi temat e diskutuara?**

Në ceremoninë e hapjes ishin të pranishëm dhe z.Kenneth OE Sundin, themelues i "SME Academy", përfaqësues nga Ambasada e Holandës në Shqipëri, përfaqësues nga Ambasada e Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri si dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme në Shqipëri, ku po përmend z.Ilir Halilaj zëvendësministër i Bujqësisë, etj. Në total morën pjesë 50 veta ku ishin studentët të universiteteve të ndryshme dhe përfaqësues të bizneseve si agropëpunim, tekstilë, shërbime konsulence, E-Komerc, llogjistikë transporti ndërkombëtar, etj.

**Cilat janë disa prej mundësive që u ofrohen nga "SME-Albania" dhe nga ky trajnim sipërmarrësve shqiptarë?**

Ky institut do t'u ofrojë mundësi sipërmarrësve të mësojnë dhe të njihen me praktika e koncepte të reja gjatë drejtimit të bizneseve të tyre, në mënyrë që të kenë mundësi të adresojnë problematikat, që lindin në sektorët dhe bizneset përkatëse. Do të zhvillohen mekanizma mbështetjeje dhe programe të reja të zhvillimit të biznesit, që ndihmojnë sipërmarrësit aktualë dhe të ardhshëm në rritjen e biznesit të tyre dhe zhvillimin e kapaciteteve. Sipërmarrësit e vegjël dhe të mesëm kanë nevojë të rrisin njohuritë e tyre vazhdimisht lidhur me mundësitë në Shqipëri dhe në tregjet ndërkombëtare, zhvillimet në sektorët përkatës, menaxhimin financiar dhe formulimin e strategjive që rrisin shitjet dhe fitimet.

**Sa i vlefshëm është për studentët e ekonomikut një trajnim i tillë?**

Absolutisht që interesi nga ana e studentëve ishte i lartë. Madje, në çdo kohë interes ka nga studentët që bëjnë kërkime në fushat e tregtisë ndërkombëtare dhe hulumtimit të tregut, apo edhe ata që do të dëshironin një vend pune në sektorin privat, trajnime të këtij lloji dhe niveli janë tepër të nevojshme dhe me interes. Pjesëmarrësit u

## Temat e trajtuara në "SME Summer Academy"

- ◆ Guerrilla Marketing për biznesin e vogël dhe Networking si një strategji marketingu, nga Z.Keneth OE Sundin, themelues i SME Academy Network.
- ◆ Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit, nga z.Daniel Guçe, ekspert për aftësitë e SME-ve, drejtor i Programit të SASME 2018.
- ◆ Programet Interreg IPA 2014-2020, nga Z.Gentian Xhaxhiu, Departamenti i Fondeve të BE-së, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- ◆ Bashkëpunimi tregtar Shqipëri-Kinë, nga Z.Lian Gang, këshilltar ekonomik e Tregtar, Ambasada e Kinës në Shqipëri.
- ◆ Hyrje në strategjinë dhe planifikim e eksportit, nga Z.Alex Silvestri, konsulent dhe ekspert i zhvillimit të SME-ve, Universiteti Sussex, Britani e Madhe.
- ◆ Marrëveshjet tregtare shqiptare: CEFTA, EFTA, BE, etj., nga znj.Anxhela Bushati, përgjegjëse e sektorit të menaxhimit të programeve të Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Financës dhe Ekonomisë.
- ◆ Ligjin i Procedurave Doganore në Shqipëri, nga z.Drilon Bushati. Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

pajisën me një certifikatë. Gjithashtu, u ofrua një bursë për pjesëmarrje në një trajnim 1-mujor në Akademinë për Biznesin Ndërkombëtar (AIBO) në Pekin në Kinë.

**Cilët janë disa prej bashkëpunëtorëve ndërkombëtarë të "SME Albania"?**

Partnerët e Akademisë Verore për SME janë Ambasada e Holandës në Shqipëri, Ambasada e Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri, Programi Italo-Shqiptar për zhvillimin e SME-ve në Shqipëri (PRODAPS Albania), SME ACADEMY dhe ETF European Trainig Foundation.



Presidenti s'e dekretoi, Zaev: Ivanov duhet të nënshkruajë ligjin

# Ligji për emrin e Maqedonisë, Kuvendi e miraton sërish

*Xhaferi: Kryen shkelje ligjore nëse nuk pranohet*

Gjorge Ivanov, presidenti i Maqedonisë duhet ta nënshkruajë ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes me Greqinë, ndërsa referendumi vetëm do ta konfirmojë këtë, apeloj sot kryeministri Zoran Zaev. Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetareve pas lëshimit në përdorim të sistemit të parë fotovoltait në objekt privat, Zaev përmendi se për herë të parë pas 27 viteve qytetarët kanë mundësi të vendosin për të ardhmen e Maqedonisë. "Besoj në popullin tonë dhe në suksesin e procesit, me të cilin do të mburren shumë gjenerata", tha kryeministri. Duke e quajtur Marrëveshjen korrekte dhe të drejtë, Zaev përmendi se ajo u ratifikua dy herë. Ndërkohë nga ana tjetër, Kuvendi i Maqedonisë sërish ka ratifikuar Marrëveshjen për emrin me Greqinë, pasi votimi i parë ka dështuar për shkak të refuzimit të presidentit të shtetit, Gjorge Ivanov për ta dekretoar ligjin. Edhe votimi i së enjtes ka kaluar me 69 vota pro, dhe vetëm një votë të përbajtur, ndërkohe nuk ka pas asnjë votë kundër, pasi në seancën parlamentare nuk ishin të pranishëm deputetët e opozitës maqedonase VMRO-DPMNE-së. Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi ka thënë se "presidenti Ivanov është i obliguar me Kushtetutën që kësaj radhe ta dekretojë ligjin, në të kundërtën ai bën shkelje ligjore". Xhaferi ka paralajmëruar se ligjin do ta dërgojë për publikim në "Gazetën Zyrtare" pa firmën e kreut të shtetit,



Kuvendi i Maqedonisë

**ZORAN ZAEV**

"Presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov duhet ta nënshkruajë ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes me Greqinë, ndërsa referendumi vetëm do ta konfirmojë këtë. Besoj në popullin tonë dhe në suksesin e procesit, me të cilin do të mburren shumë gjenerata", - tha Zaev.

tetuese. Dimitrov tha se nuk mbrohet Kushtetuta duke e shkelur atë. "Pika e parë është më përbajtësore, pasi aty thuhet se nuk mund të pranohen ide dhe propozime që rrezikojnë identitetin nacional maqedon. Unë dua t'ju bind se asnjë anëtar i qeverisë, as kryeministri, e askush tjetër nuk do të pranohet ide të tilla. Marrëveshja jo vetëm që nuk e rrezikon identitetin, gjuhën dhe gjithçka që ka të bëjë me veçoritë maqedonase, por përkundrazi i forcon edhe më shumë", u shpreh ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov. Por, pavarësisht kësaj, opozita ka paralajmëruar padi penale ndaj të gjithë tyre që pretendon se kanë "tradhtuar interesat nacionale maqedonase". "VMRO DPMNE nuk do të bëhet pjesë e kapitulumit. Nuk do të marrim pjesë në seancën ku miratohet kjo marrëveshje aq e dëmshme për ndryshimin e emrit të shtetit dhe prek identitetin e maqedonaseve", tha Sekretari i Përgjithshëm i VMRO-DPMNE-së Igor Janushev. Ndërkohë që partitë shqiptare votuan marrëveshjen me të cilën sipas tyre zhbllkohet procesi euro-integruar.

## Ali Ahmeti: S'ka forcë që mund të pengojë marrëveshjen

Menjëherë pasi në Kuvendin e Maqedonisë u votua për herë të dytë ligji për ratifikimin e marrëveshjes mes Athinës dhe Shkupit, kreu i BDI-së Ali Ahmeti ka uruar qytetarët e Maqedonisë. Në një video të postuar në 'Facebook' nga deputeti i BDI-

së Artan Grubi, kreu i integristëve, dëgjohet duke thënë se marrëveshjen për emrin mes Maqedonisë dhe Greqisë nuk ka forcë që mund ta pengojë. "Urime, urime. Ky është një proces i pandalshëm. Proceset e pandalshme nuk ka forcë që mund t'i ndalë", ka thënë kreu i BDI-së Ali Ahmeti, në

dalje nga salla e Kuvendit. Ligji në fjalë u votua me 69 vota pro. Në bazë të marrëveshjes Maqedoni - Greqi synohet t'i jepet fund kontestit mes dy vendeve fqinje që zgjati më shumë se dy dekada e gjysmë për çështjen e emrit, në bazë të cilës shteti emërohet Maqedonia e Veriut.

sukur edhe ligjin për gjuhën shqipe, që gjithashtu dy herë është miratuar në Kuvend për shkak të refuzimit të presidentit për ta

dekretoar. Edhe shefi i diplomacisë, Nikolla Dimitrov i ka bërë thirrje presidentit të Maqedonisë, Gjorgje Ivanov që të dekre-

tojë Marrëveshjen për emrin, pasi sipas tij nuk qëndrojnë pretendimet e presidentit Ivanov se kjo marrëveshje është antikush-

**SHKURT**

**Gjermania nis shpalesjen e planit për refugjatët**

Gjermania ka nisur bisedimet dypalëshe me vendet europiane pas vendimit për të mbyllur dyert për emigrantët. Kancelarja gjermane Angela Merkel u takua në Berlin me kritikun e saj kryesor mes liderëve europianë, kryeministrin hungarez Viktor Orban. Ai u shpreh i gatshëm për të bashkëpunuar për zgjidhjen e krizës, por sipas tij Hungaria nuk ka kapacitete për të strehuar azilkerkues të rinj. Ndërsa ministri i Brendshëm gjerman Zehner u dhëtoi drejt Vjenës për të bindur kancelarin Kurz, për të pranuar azilkerkuesit e strehuar në Gjermani, por të regjistruar në Austri.

**Londër, tërmet në aeroport**

Një tërmet ka goditur aeroportin e Gatwick në Londër dhe qytete të tjera të Anglisë. Pasagjerët në aeroport raportuan se ndjeheshin të tokës. Sipas Shërbimit Gjeologjik Britanik, tërmeti ishte me magnitudë 3. Mediat angleze nuk kanë raportuar për dëme materiale apo persona të lënduar. Qytetarë të tjerë thanë se kanë dëgjuar "dy shpërthime të mëdha". Disa banorë dolën në frikësuar nga shpëtitje të tyre. Autoritetet deklaruan se kanë marrë raportime për tërmet edhe në Dorking, Horley, Surrey, Horsham, Charlwood dhe Newdigate.

**Protestoi në Statujën e**

**Lirisë, arrestohet 44-vjeçarja**  
Një grua që u ngjiti në Statujën e Lirisë në Nju Jork dhe u ul në bazën e monumentit, u dërgua në paraburgim, tha policia. Autoritetet evakuuan turistët për 3 orë, sa edhe zgjati mosbindja e saj përballë autoriteteve lokale dhe federale. Gruaja u identifikua si Therese Okoumou 44 vjeç, imigrante nga Kongo. Raportohet se ajo protestoi kundër politikës së presidentit amerikan, Donald Trump, për "zero-tolerancë" ndaj imigracionit. Me këtë politikë, mijëra familje janë ndarë nga autoritetet amerikane pasi kanë kaluar kufirin e SHBA-së nga Meksika.

**Francë, dhunë kundër policisë në Nantes**

Banorët e një lagjeje në Nantes shpërthyen në dhunë, në shenjë revoltë pas vrasjes nga policia të një të 22-vjeçarit gjatë kontrollit të automjetit. Dhuna shpërtheu në lagjen Breil, mbrëmjen e të martës. Banorët i vunë flakën dhjetëra automjeteve, një supermarketi dhe disa objekteve publike të zonës. Ata akuzuan policinë për dhunë të tepruar ndaj një personi të paarmatosur. Situata u qetësua vetëm gjatë orëve të vona të natës. Autoritetet lokale thanë se policia ishte e detruar të qëllonin ndaj 22-vjeçarit, pasi ai nuk i bind urdhrin për kontroll.

**Dialogu me Serbinë, reagon drejtori i zyrës për Kosovën**

## Gjuriç: Shqiptarët s'mund të bëjnë asgjë pa biseduar me ne, veç të 'shesin mjegull'

Në i kemi shumë të qarta aspiratat shqiptare, por edhe ata duhet ta kenë të qartë se nuk mund të bëjnë asgjë pa pasur bisedime me Serbinë, përveç se t'i 'shesin mjegull' popullit të tyre". Kështu deklaroi drejtori i të ashtuquajturës Zyrës për Kosovën, Marko Gjuriç. Ky i fundit tha se për Serbinë nuk është befasi kur dikush nga Prishtina nuk pajtohet me marrëveshjen, por kjo tregon se një pjesë e tyre është e papërgatitur dhe kjo pjesë nuk e respektonte atë që është diskutuar. Sipas tij, është e rëndë-

sishme që të gjendet një lloj marrëveshjeje midis Beogradit dhe Prishtinës për shkak të së ardhmes së të gjithë atyre që jetojnë në këtë rajon. Megjithatë, ai mendon se kjo nuk do të jetë e lehtë, sidomos duke mbajtur parasysh deklaratat, të cilat sipas tij janë mjaft jorealiste. "Interesi ynë është se pavarësisht nga retorika ne do të shkojmë përmes bisedimeve që të gjejmë një zgjidhje. Gjithashtu, edhe bashkësia ndërkombëtare po lufton me ne, por përsëri kjo është një detyrë shumë e vështirë", tha Gjuriç, për TV Pink, përcjell Telegrafi. Ai

shtoi se Prishtina beson se tani është koha me e përshatshme që të ketë politikanë në pushtet si Sasha Janković, i cili ofron dy karrige në OKB. "Janković, Jeremiç dhe Gilas do të përshatën, sepse dihet e kaluara e tyre. Ky është ideali i tyre, e jo të kontrbuojnë në mirëqenien e Serbisë", tha ai. Para dy ditësh, Gjuriç deklaroi se shefi i delegacionit të Prishtinës për bisedime me Serbinë, Avni Arifi, mund të flasë vetëm për trashëgiminë e tij duke thënë se ai nuk është kompetent, sidomos sa i përket territorit.



Marko Gjuriç

**MARKO GJURIÇ**

"Ne i kemi shumë të qarta aspiratat shqiptare, por edhe ata duhet ta kenë të qartë se nuk mund të bëjnë asgjë pa pasur bisedime me Serbinë, përveç se t'i 'shesin mjegull' popullit të tyre. Interesi ynë është se pavarësisht nga retorika, do të shkojmë përmes bisedimeve që të gjejmë një zgjidhje", - ka thënë Gjuriç.

Opinion i Ditës

# Kambanat bien për multilateralizmin

Dr. Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... historike për pak sa nuk e prishën "Unionin" ose bashkimin e tyre historik. Grindjet dhe zhurma shurdhuese djavore nuk ishtë aspak "luftë bërrylash" për push-të, ndërsa kriza e azilit ishte vetëm "gjethe fiku". Aq më tepër kur dy vitet e fundit në Gjermani ka një rënie mbi 70 për qind të numrit të azilkërkuësve. Në fakt, thelbi i tensionimit të paparë ndërmjet këtyre dy partive me vokacion të theksuar evropian kishte të bënte me prirjen për zgjidhjen e krizës së azilit me frymë dhe marrëveshje evropiane/shumëpalëshe (multilaterale) nga CDU e kancelares Merkel dhe zgjidhjes së njëanshme (unilaterale) të CSU-së bavareze. Madje, në kulmin e kësaj krize, kryeministri bavarez, Markus Söder kishte deklaruar se "multilateralizmi po i vjen fundi".

Gjithashtu, siç ishte nënvizuar në shkrimin tonë më 21 qershor "Divorc me simotërën bavareze apo fundi politik i Merkel", lidhshipi bavarez shpresonte me këtë rast të fitonte dhe kapitalin e humbur elektoral në zgjedhjet lokale të muajit tetor. Falë vendosmërisë dhe lidhshipit të kancelares Merkel, u shmanng rënia e koalicionit qeveritar dhe mbrojtje e kurajë politike edhe fryma e multilateralizmit.

Jehona e këtyre kambanave është vërtet alarmuese, sepse nuk bëhet më fjalë për deklaratime të castit e në ndonjë vend apo dy, por për hapa e veprime konkrete dhe të vazhdueshme për denoncimin e jo pak traktateve dhe organizatave shumëpalëshe ose multilateralizmit, dështa e paparë në 70 vitet e fundit në Evropë dhe më gjerë.

Kështu, disa ditë më parë Rusia paralajmëroi se mund të largohet nga Organizata për Parandalimin e Armëve Kimike (OPCE) pas një votimi javët e fundit lidhur me përdorimin e këtyre armëve në Siri. Dihet se prirjet e vendimeve të njëanshme morën hov pas ardhjes në Shtëpinë e Bardhë të Presidentit Trump. Rasti më i freskët daton më 20 qershor kur ajo shpalli tërheqjen nga Këshilli të Drejtave të Njeriut të OKB-së me seli në Gjenevë më 47 anëtarë.

Ky vendim pason denoncimin e Traktatit Ndërkombëtar të Klimës së Parisit, atij të Tregtisë së Lirë, vendosjes së njëanshme të tarifave mbi importet e çelieqeve dhe aluminit dhe Marrëveshjen Bërthamore gjashtëpalëshe me Iranin.

Ndërkohë, krahas përplasjeve me BE-në dhe ndonjë audim për rishikimin e pozicionit amerikan në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) shqetësimet të kësaj natyre ka edhe në raportet SHBA-NATO. Le të shpresojmë se Samiti i NATO-s javën e ardhshme do të ndihmojë në krijimin e një frymë të re afirmuese bashkëpunimi të Aleancës Transatlantike.

Krahas multilateralizmit në përgjithësi, kambanat e alarmit po bien gjithnjë e më fort dhe për vetë Bashkimin Evropian, mbijetesën dhe të ardhmen e tij politike. Breshitë ishte arritja e parë e euroskeptikëve, edhe pse ajo mund të rezult-



tojë si "fitorja e Pirros". Mesazhe të tilla shqetësuese po vijnë edhe nga vendet e Grupit të Visegradit, ndonjë liderët e tyre janë treguar të kujdesshëm duke thënë se "nuk janë kundër BE-së, por për ta ribërë atë". Në ballë të fushatave agresive lobuese kundër multilateralizmit janë vënë dukshëm forcat populiste dhe ekstremiste në disa vende perëndimore, duke përfshirë dhe ato themeluese të BE-së, si Gjermania, Franca, Holanda dhe së fundi Italia. Kështu, Lideri i "Lega Nord", ministri i ri i Brendshëm italian, Matteo Salvini e tha troç sapa hyri në zyrë se, "Pas një viti do të shohim nëse do të ketë Evropë të Bashkuar ose jo". Gjithnjë e më shumë po dëgohet refreni i "korit" politik në rritje kundër Traktatit të Dublinit lidhur me prirjen dhe trajtimin e azilantëve dhe financimin e këtij procesi nga BE-ja.

Ashtu nën zë dhe si pa u kuptuar, kësaj rryme po i bashkohet dhe Holanda. Muajt e fundit ajo i ka thënë prerë "Jo" shtimit të buxhetit të ri të BE-së, krijimit të një autoriteti financiar evropian dhe së fundi, çeljes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë gjatë këtij viti. Ndaj, jo rastësisht Hagës po i referohen dhe si "Mister No Europe". Dukuri tjetër intriguesë në disa vende anëtarë është prirja e mbivlerësimit të karakterit ndërgregeritar (kombëtar) të BE-së në dëm të aspektit supranacional; ky i fundit përbën specifikën dhe avantazhin kryesor të BE-së krahasuar me organizatën tjetra ndërkombëtare. Shembulli më i freskët në këtë drejtim ishte hedhja praktikisht poshtë e Rekomandimit të Komisionit Evropian për çeljen e menjëhershme dhe pa kushte të negociatave të anëtarësimit me vendin tonë dhe sidomos vendosja e procedurës së miratimit të çeljes së tyre tashmë nga secili parlament i vendeve anëtarë, sikur të mos mjaftojë Parlamenti dhe Komisioni Evropian! Pa mohuar "gjinahet" tona të analizuar në shkrimet e mëparshme dhe një perceptim përgjithësisht jo të pëlqyeshëm publik në ato vende, le ta themi hapur se vendet skeptike nuk i hanë aq shumë merak për meritat dhe reformat tona se sa shfrytëzimi i rastit më të parë për t'i treguar "muskujt" Komisionit Evropian supranacional se "jemi në këtu, populli i vendeve anëtarë që vendos dhe jo establishmenti dhe burokracia e Brukselit". Në fakt, ky mesazh pritet të jetë kryefjala e zgjedhjeve të reja evropiane 2019 e forcave nacionaliste dhe populiste dmth, zhveshja e BE-së nga komponenti multilateral/supranacional dhe fetishizimi i elementit ndërgregeritar/kombëtar. Zgjerimi i mëtejshëm i këtyre prirjeve të njëanshme do të vinte seriozisht në rrezik serioz gjithë sistemin e marrëdhënieve shumëpalëshe. Mirëpo ky i fundit përbën themelin e rendit të ri botëror të krijuar pas Luftës së II Botërore; dihet se multilateralizmi erdhi si domosdoshmëri jetike për shmangien e luftërave, mbrojtjen dhe zhvillimin e paqes dhe stabilitetit në botë. Përvoja ndërkombëtare ka dëshmuar bindshëm se fetishizimi i shteteve kombëtare, vendosja e interesave të tyre mbi gjithçka shoqëruar me përshkallëzimin e nacionalizmit, populizmit dhe ekstremizmit, me gjithë arritjet dhe sukseset fillëstare kanë pasur fat tragjik; ishin ato që çuan në lindjen dhe përshkallëzimin e fashizmit, nazizmit dhe komunizmit e për pasojë në të dyja luftërat më të përgjakshme botërore.

Ja pse, mbi 7 dekada më parë, baballarët e Evropës së bashkuar menduan se rendi i ri botëror duhej të mbështetej jo më në parimin se ka të drejtë më i forti, pra jo më "në të drejtën e forcës së njëanshme", por në "forcën e së drejtës ndërkombëtare", jo në grindje e përplasje dypalëshe, por në bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar. Mirëpo funksionimi i këtij rendi të ri botëror u bë i mundur sepse për të mbrojtur dhe zhvilluar vlera dhe interesa shumë më të gjera dhe afatgjata, një numër shumë i madh shtetesh "dorëzuan" vullnetarisht një pjesë të sovranitetit dhe vendimmarrjes së tyre tek institucionet ndërkombëtare politike, ekonomike, sociale, juridike, ushtarake, kulturore etj., me krye Kombet e Bashkuara. Krijimi më vonë i Bankës Botërore, FMN-së, Këshillit të Evropës, BE-së, OSBE-së etj., ishin rrjedhojë logjike e kësaj domosdoshmërie historike.

Vlerat dhe përparësitë e shpuarja të multilateralizmit janë të

shumta e të gjithanshme. Veç garancive për shmangien e luftërave dhe konflikteve dypalëshe/rajonale dhe ndërmjetësimit për zgjidhjen e krizave të ndryshme, ato krijojnë një kuadër të njehsuar ligor të detyrueshëm për çdo vend; ato krijojnë truallin dhe platformat e nevojshme goftë dhe informale për shkëmbime idesh, mendimesh dhe përvoja, si psh., Forumi Botëror i Davos, Konferenca e Sigurisë në Mynih e të tjera. Më tej, ato krijojnë kanale të dobishme në komunikimin ndërkombëtar nëpërmjet takimeve dhe forumeve periodike, çka çon në rritjen e mirëkuptimit ndërmjet vendeve, si baza e besimit dhe bashkëpunimit të qëndrueshëm. Prania në këto organizata dhe forumet rrit imazhin dhe besueshmërinë të partnerët, si në rastin e aderimit tonë në NATO, negociatat e anëtarësimit me BE e të tjera.

Plus që dokumentet e organizatave ndërkombëtare shërbejnë dhe si burime të padiskutueshme referimi në raste të ndryshme keqinterpretimesh dhe mos pajtimit, si OSBE-ja, Këshilli i Evropës, Parlamenti Evropian, OECD-ja etj. Njihet tashmë roli i padiskutueshëm i ODIHR në monitorimin e zgjedhjeve, duke u dhënë vlerën e besueshmërisë dhe të legjitimitetit.

Avantazh tjetër i madh i traktatave dhe marrëveshjeve shumëpalëshe është se aty janë bashkuar vende me sisteme të ndryshme politike dhe sociale, që në plane të tjera do ta kishin të pamundur komunikimin dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Nga ana tjetër, është e vërtetë se organizatat dhe marrëveshjet shumëpalëshe kanë pasur dhe jo pak dështime e gabime. Kryesorja, nga projekte frymëzuese politike, ekonomike dhe sociale, e kanë të pruar me njëzimëri e rregullave dhe procedurave burokratike, duke u kthyer siç thotë politologu amerikan David Graber, në "perandori rregullash të ngurta"; për pasojë, në vend që të lehtësojnë jetën e përbashkët, ato e kanë vështirësuar atë. Shtimi i papunësisë kronike, varfërisë, skamjes, dhunës, pasigurisë etj., janë rrjedhoja të drejtpërdrejta dhe të sistemit shumëpalësh, pa aftësisë së tij për t'u përshtatur situatave të reja dhe shkëputjes nga realitetet e përditshme.

Problemi është se këto mungesa dhe mangësi, në vend të analizave tërësore, vetëm se po amplifikohen në mënyrë abuzive nga forcat nacionaliste dhe populiste, duke injoruar çdo anë të mirë dhe pozitive të tyre. Agresiviteti dhe zhargonit i drunjtë në këto raste shpjegohet me ngutjen e tyre për të denoncuar dhe mohuar multilateralizmin si sistem, ose të paktën një pjesë të tij që u prish punë. Vetëm kështu forcat populiste mund të kenë sukses në joshjen e turmave. Sepse thelbi i aktivitetit nacionalist dhe populist është ndarja e papajteshme në "ne dhe ata" "ne dhe elitat kombëtare" me dhe organizmat ndërkombëtare, sidomos FMN, Banka Botërore, Banka Qendrore, Brukseli, "ne dhe kapitalizmi financiar" etj.

Kësajsoj, synohet t'i çetë gradu-

alisht rruga deligjitimitimit dhe kur të vijë rasti, çmontimit të multilateralizmit në segmentet e tij më vitale.

Mirëpo, këto tentativa bien ndesh hapur me globalizmin si tipari mbizotërues i jetës ndërkombëtare. Padyshim që kushdo, edhe SHBA, si themeluesi dhe sponsori kryesor me kontribute të pallogaritshme historike edhe në fushën e multilateralizmit është në të drejtën e tij që të kritikojë dhe të shprehë në çdo kohë kundërshtime parimore ndaj traktateve ndërkombëtare dhe partnerëve të veçantë, siç ka bërë dhe më parë, por jo duke u larguar, duke zbehur e ca më pak duke çuar në çmontimin e multilateralizmit; por duke e përmirësuar dhe reformuar thellë atë në të gjithë komponentet e tij me një bashkëpunim luajal me të gjitha palët e interesuara dhe kurrsesë me vendime të njëanshme. Kjo përjashtje përbën dhe ADN-në e multilateralizmit. Madje, edhe kur mund të jenë shteruar rrugët dhe mjetet e tjera, problemet, mangësitë dhe krizat mund të trajtohen dhe zgjidhen drejt nëpërmjet kanaleve dhe demarsheve diplomatike dy dhe shumëpalëshe; natyrisht ky kërkim kohësh dhe hapësirën e vjet, larg presioneve dhe ultimatumëve të njëanshme politike.

Veç sa sipër, reformimi, ose çmontimi dhe jo çmontimi i multilateralizmit bëhet edhe më i nevojshëm tani për shkak të krizave dhe sfidave serioze shumëdimensionale me të cilat ballafaqohen shumë vende dhe organizma ndërkombëtare. Sidomos kur bëhet fjalë për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit, ndryshimet klimatike, lufta ndaj krimit dhe korrupsionit, azilin, emigracionin, terrorizmin ndërkombëtar, etj. Këto dhe të tjera sfida globale nuk mund të trajtohen e ca më pak të zgjidhen vetëm nga një apo disa vende, sado të mëdha e të fuqishme qofshin, pa bashkëpunimin e gjithë komunitetit ndërkombëtar dhe për rrjedhojë, forcimin e multilateralizmit.

Ndaj, me të drejtë, Presidenti Makron theksoi në fjalën e tij përpara Kongresit Amerikan në muajin prill se "sot kërkohet një model multilateral i ri, efektivi, i përgjegjshëm dhe i orientuar më shumë nga rezultatet që të respektohen, mbrojtje dhe lejoje shkëmbimin e lirisht të kulturave dhe identiteteve tona".



Opinioni *i* Ditës

# Nuk është vetëm teatri, ka akoma

Nga Dritan Hila

(vijon nga faqja 1)

... një firmë private sepse ashtu kishin urdhër. Disa prej tyre ka mundësi që nuk e dinin çfarë bëhej. Më kujtohet përpara dy vitesh në emisionin "Bardh e Zi", ku përveç meje ishte e ftuar edhe Klotilda Ferhati, në ato kohë drejtuese e grupit të këshilltarëve socialistë në Bashkinë e Tiranës dhe sot deputete, që akuzës sime se tek këndi i lojërave tek Rruga e Elbasanit do ndërtohet kullë, i përgjigjej me mohim. Madje ironikisht. Sot kulla ka filluar dhe po hedh shtat. Ndaj nuk jam i prirur t'i gjykoj negativisht shumë prej tyre, pasi ca janë për bukën e gojës, ca se aq dinë dhe ata që dinë, kanë interesat e tyre.

As krahu tjetër nuk ka ndonjë lavdi të madhe, sepse shumë prej tyre kanë mbrojtur kauza fantomatike të Berishës dhe e kanë quajtur të zezën të bardhë pa iu dredhur qerpiku, kudo: Në salla parlamenti, studio televizive dhe publik.

Sot shumë deputetë të maxhorancës diskutojnë për historinë pa qenë të tillë, për arkitekturën pa pasur kualifikimin përkatës, për leverdinë ekonomike pa pasur atë shkollë. Edhe në të shkuarën kemi parë krahu tjetër që kur ka qenë në podium, ka qenë po aq pa logjikë.

As tahmaqarllëku i Edi Ramës nuk është ndonjë gjë e re, pavarësisht se tashmë është shumë lakuriq, sepse edhe demokratët kanë historitë e tyre të megakorruptionit.

Me hapin që po ndërmerr Rama nuk është se po pakëson radhët e votuesve të tij. Personalisht jam shumë skeptik. Turmat e kanë kujtesën e shkurtër. Dhe as do t'i ikin në krahu tjetër.

Por pas rënies së kinemave, stadiumit dhe nëse ndodh, edhe teatrit, do t'u vijë radha të tjerave. Tirana po mbetet pa kujtesë historike. Dhe ky është një hap që shkon përtej hajdutllëkut. Një ndër akuzat që u është drejtuar shpesh shqiptarëve nga armiqët e tyre është mungesa e institucioneve dhe të shkuarës historike, ku prezenca e godinave është një dëshmi e rrallë. Hapësira shqiptare ka shumë pak të tilla. Ne kemi një gjuhë të kodifikuar vonë, që vuan akoma debatet e standardit, kemi arkitekturë të pakët dhe jo autoktone dhe histori të shkruara nga të tjerët. Nëse ka një luftë që i bëhet një kombi, kjo është shkatërrimi i memories së tij. Dhe me këtë sipërmarrje Edi Rama po merr dyshime të mëdha përsipër. Nëse do të ishte dikush tjetër, ky do ishte ndër hamendësimet e para, por në rastin e Ramës duke pasur parasysh imazhin e tij si ekscentrik, nuk ka ndodhur. Por rasti i teatrit dhe synimi i tij për të rrafshuar gjithçka që ka një kujtesë historike, sjell në vëmendje edhe



vendimet që kështjella sinjifikative për historinë tonë të kthehen në klube. Dhe këtu memo-

ria fillon e rëndohet. Të bësh teori komploti në një komb që e ka të ndezur fantazinë

Por pas rënies së kinemave, stadiumit dhe nëse ndodh, edhe teatrit, do t'u vijë radha të tjerave. Tirana po mbetet pa kujtesë historike. Dhe ky është një hap që shkon përtej hajdutllëkut. Një ndër akuzat që u është drejtuar shpesh shqiptarëve nga armiqët e tyre është mungesa e institucioneve dhe të shkuarës historike, ku prezenca e godinave është një dëshmi e rrallë. Hapësira shqiptare ka shumë pak të tilla. Ne kemi një gjuhë të kodifikuar vonë, që vuan akoma debatet e standardit; kemi arkitekturë të pakët dhe jo autoktone dhe histori të shkruara nga të tjerët.

si ky yni është e thjeshtë. Por pas akteve ndaj monumenteve historike, shpalljes së dhjetë minoriteteve në Shqipëri dhe bisedimeve okulte me Greqinë, ka diçka që nuk shkon. Këtu fantazia thahet dhe faktet të bëjnë të stosh dyshimet.

Fatkeqësisht tek ne tradhtia kalon shpesh si muhabet me jhanesh, ku të bësh ca pare është zotësi, pavarësisht rrugës. Dhe mbase një popull parapolitik kështu i gjykon raportet me vendin dhe të ardhmen. Vetëm se kur vijnë kohët që politika e madhe e botës të diskutojë siç bën një herë në njëqind vjet dhe të kërkojë dëshmitë e shqiptarëve, dosja jonë do të jetë bosh. Sepse kullat e Edi Ramës janë vetëm dëshmi e delirrit dhe tahmasë së tij, por jo e ekzistencës së një kombi./dritare.net

## HOROSKOPI

### DASHI

Mos u vendosni shumë kufizime dëshirave tuaja, ndryshe do t'ju duhet të kënaqeni me gjëra të vogla. Të duash dhe të mundesh, mos vallë i keni harruar këto? Ka disa objektiva në profesionin tuaj, që do të donit t'i arrinit. Atëherë armatosuni me ngulm dhe vullnet!

### DEMI

Duke i besuar ndonjë rastësie të fatit do të arrinit të mos e ngadalësoni ritmin e punës. Ndoshka fati do të ndërhyjë! Edhe pse jo gjithmonë ia dilni të qëndroni në një hap me kolegët tuaj, mos u shqetësoni. Keni burime të tjera të vjera.

### BINJAKET

Së shpejti do të ndiheni të inkurajuar dhe të qetë, duke qenë se do të gjeni, më fund, zgjidhjen e një çështjeje, që po ju shqetësonte prej kohësh. Më të fituar qetësinë, mund edhe të tentoni të rifilloni një lidhje të vjetër.

### GAFORJA

Pas një mëngjesi harmonie dhe qetësie, me bashkimin e Diellit me Hënën, kalimi i kësaj të fundit tek Peshorja mund të sjellë pak bezdisje. Është mirë të përgatiteni për një mbrëmje jo të qetë. Mbyllni derën dhe ndizni televizorin për t'u argëtuar ndopak.

### LUANI

Lejoni vetës një pasditë të paqët, për qetësi absolute. Pozicionimi i Hënës në lidhje me Merkurin gjatë mbrëmjes, mund të bëjë që t'ju krijohet një gjendje nervozizmi. Mos i shmangni të tjerët, por, gjithashtu, jepini vetes disa momente qetësie duke qëndruar vetëm.

### VIRGJERESHA

Përpiquni të gjeni ekuilibrin e duhur në marrëdhëniet me të tjerët: jo të gjithë mund të kenë dëshirë të flasin me orë të tëra në rrejtje sociale. Duke punuar për përgatitjen e gjërave të reja, përpiquni të mos shqetësoheni shumë. Mjafton të organizoheni.

### PESHORJA

Të ndriçosh të gjitha zonat e errëta që keni gjetur përgjatë rrugës nuk është e lehtë. Është më mirë të përballesh me gjërat me radhë, sesa të mbash shumë kunguj nën një sqalet. Mos i merrni të gjitha gjërat e mirëqena dhe shikoni përtej asaj që duket në pamje të parë, për të mos gabuar.

### AKREPI

Ditë e përsosur për të rivendosur harmoninë në çift, nëse, për çfarëdolloj arsye, gjërat nuk po shkonin mirë. Pozicioni i Diellit dhe Hënës është në favorin tuaj. Me partnerin dhe në familje do të keni një ambient të shkëlqyer, ku asgjë nuk do t'ju duket e pamundur.

### SHIGJETARI

Disa çështje burokratike do t'ju mbajnë të tensionuar. Duhet të mësoni t'i menaxhoni duke pasur më shumë zotërim mbi ato aspekte që mund t'ju shkaktojnë tensione. Në vend që të lejoni që t'ju kapë ankhii, përkushtojuni një veprimtarie tjetër.

### BRICJAPI

Do të përfitonin nga një cast lodhjeje të një kolegu për të treguar besnikëri dhe përgjegjshmëri, duke fituar kështu pikë në sytë e shefit. Të përveshësh mëngët nuk është problem, aq më tepër nëse e dini që do t'ju shpërblehet bujarisht.

### UJORI

Ju shqetësojnë diskutimet me drejtuesin? Rrini të qetë, pasi nuk donte t'ju qortonte, por donte t'ju jepte disa këshilla të vjera. Mund të përmirësoheni ndjeshëm, nëse angazhoheni pak, duke bërë që të meritoni ndoshka edhe një rritje rroge.

### PESHQIT

Me planifikim të kujdesshëm të çdo angazhimi, sot do të gjeni kohë edhe për argëtim dhe për të qenë pranë personave interesantë. Dini si të jepnin maksimumin edhe kur situata nuk do të dukej fare si ajo idealeja.

**D**idie Dëshamp e di mjaft mirë se ndaj Uruguait do të hasë telashe. Kjo, sepse skuadra e Oskar Tabarezit është shumë e fortë në prapavijë dhe e fortë në sulm. Mbi të gjitha, mungesa e Matuidit, të cilin Dëshamp ende nuk i ka gjetur një zëvendësues, tek- sa në balotazh janë Fekir dhe Tolizo. "Uruguai është një skuadër amerikano-latine dhe kjo e bën një kundërshtar shumë të fortë. Do të kemi përballë një rival të ashpër dhe agresiv. Uruguai nuk është Argjentina, ndaj për ne vështirësitë rriten duke



**Tabarez: Franca, ekip i bekuar me talente**

**Deshamp: Kujdes, Uruguai nuk është Argjentina!**

parë edhe ambicidet e rivalit. Në vitin 2014 u eliminua nga Gjermania, të cilën e eliminuam në gjysmëfinalen e Europianit dy vite më parë. Por, ai ishte një tjetër kundërshtar. Nëse arrijmë gjithmonë në fazën me eliminim në turnetë e mëdhenj për kombëtaret, atëherë skuadra ime mund të

cilësohet kompetitive. Kjo më duket se është e patjetërsueshme". Hugo Loris dëshiron që Franca të luajë si skuadër e madhe, ndonëse Uruguai është një ekip mjaft i vështirë. Kapiteni i Francës sheh përpara dhe kërkon të arrijë objektivat. "Do të jetë një ndeshje e madhe. Tani jemi në

zemër të veprimtarisë. Jemi të fokusuar tek objektivi ynë. Ne jemi një ekip i madh dhe duhet të luajmë si të tillë. Do të përgjigjemi në fushën e lojës dhe të kualifikohemi". Uruguai i Oskar Tabarezit ka mahnitur deri më tani. Të kualifikuar në grup me pikë të plota, ata ditën të fshinin nga

fusha e lojës një "jashtëkësor" si Ronaldo, ndërsa përballë Francës do të kërkojnë që të arrijnë në gjysmëfinale. Për Tabarezin, ajo ndaj Francës është një ndeshje e vështirë. "Franca është një ekip shumë i mirë. Nga më të fortat në këtë Botëror. Nuk do të jetë një ndeshje si ndaj Portugalisë, do të reagojmë në bazë të fraksioneve të lojës. Ka një skuadër shumë të organizuar dhe është e bekuar me lojtarë me cilësi të mrekullueshme. Ne do të krijojmë një sistem loje që do të na lejojë të shprehemi dhe do t'u krijojmë problem mbrojtësve të tyre".

"Selecao" është mbrojtja më e mirë e veprimtarisë, "djajtë e kuq" janë sulmi më i mirë



Jeton Selimi

**Brazil-Belgjikë, sfida që premtion spektakël**

*Nejmar kundër Hazard, "the show must go on"*

**B**razili dhe Belgjika do të luajnë për të përçaktuar fatin e çerek-finaleve që pritet me më tepër vëmendje në Botërorin e Rusisë. Trajneri i brazilianëve, Tite, ka shprehur vlerësim maksimal për kualitetet dhe lojën e kundërshtarit, duke premtuar se sfida ndaj Belgjikës do të jetë një takim i bukur për t'u parë. Ndërsa sa i përket gjendjes së lojtarëve të tij, Tite ka konfirmuar rikthimin e Marselos. "Fuqia e madhe e Belgjikës për të krijuar lojën është e padiskutueshme, ata janë vërtet shumë të fortë. Kanë një ekip dhe trajner të mirë. Ne do të shohim një ndeshje vërtet shumë të mirë. Më duhet të konfirmoj se Marcelo do të rikthehet në fushën e lojës, ndërsa Fernandinho mund të marrë vendin e Kasemiro, që është kualifikuar". Zhoao Miranda do ketë punë ndaj Romelu Lukakut, por kapiteni i Brazilit deklaroi se mbrojtja e skuadrës së tij do të kalojë një test të vështirë ndaj Belgjikës. "Belgjika nuk është vetëm Romelu Lukaku. Ajo është një skuadër shumë e rrezikshme në sulm. Nuk do të jetë aspak e lehtë të luajmë ndaj tyre. Kanë shumë lojtarë të talentuar. Mbrojtja e Brazilit do të ketë një



test të vështirë gjatë kësaj ndeshjeje". Dueli mes Brazilit dhe Belgjikës në çerek-finalen që do të luhet në 'Kazan', është ndryshe dhe një finale mes sulmit më të mirë, "djajtë e kuq", dhe mbrojtjes më të mirë, "Selecao". Por, edhe Roberto Martinez sheh rivalitetin e Belgjikës si favorit. "Natyrisht, Brazili është favoriti. Dy ekipet janë shumë të ngjashme sa i takon talentit dhe cilësisë së lojtarëve, por diferenca janë të qarta. Ne nuk e kemi fituar kurrë Kupën e Botës. Të marrësh pjesë në një veprimtari si kjo dhe të luash i bindur se mund ta fitosh është një diferencë e madhe. Kjo është një pengesë dhe është e rëndësishme, por pavarësisht kësaj, ne duam të fitojmë. Nuk është se nuk duam ta veshim petkun e favoritit, por favoriti është Brazili dhe ky është realiteti".

**Sulmuesi shpreson kualifikimin e Uruguait**

**Kavani stërvitet, por luan vetëm në gjysmëfinale...**

**U**ruguai do të luajë ditën e nesërme ndaj Francës, për të diskutuar gjysmëfinalistin e parë të Botërorit të Rusisë. Një sfidë që premtion garë të ashpër sportive dhe shumë emocione, duke iu referuar performancës që kanë treguar skuadrat gjatë këtij turneu. Megjithatë, Uruguai pritet të ketë një mungesë të rëndësishme, pasi heroi i triumfit të fundit, Edinson Kavani



është i dëmtuar dhe pritet të mos jetë në takimin e nesërm. Ai është rikthyer në stërvitje gjatë ditës të djeshme, por vetëm një mrekulli mund ta bënte që sulmuesi i PSG-së të ishte i pranishëm për Francën. Nëse Uruguai do të bëjë një tjetër mrekulli në Botërorin e Rusisë, atëherë Edinson Kavani do të jepte kontributin e tij në gjysmëfinalen e këtij turneu.

**Babai i Higuainit sulmon Sampaolin**

**Horge: Nuk mund të mbash në stol 600 gola**


**A**rgjentina doli nga Botërori i Rusisë me kocka të thyera, pas eliminimit në fazën e 1/8-ve ndaj Francës. Trajneri Sampaoli nuk dha dorëheqjen, pavarësisht kritikave të shumta. I fundit në listën e atyre që kanë shpërthyer ndaj tij është babai i sulmuesit Gonzalo Higuain, i cili është shprehur: "Nuk ka një shpjegim që të qëndrojë. Nuk e di pse Argjentina luajti pa një numër 9 në ndeshjen me Francën.



Ndoshta trajneri ka pasur arsyt e veta, por ndonjëherë është e vështirë t'i kuptosh. Nëse në stol ke dy lojtarë, të cilët bashkë kanë shënuar 600 gola dhe nuk aktivizojn asnjërin, është e çuditshme. Nëse nuk të pëlqen njëri, fut tjetrin (Aguerron). Argjentina e nisi Botërorin me një sulmues qendër, pastaj përfundoi me Enzo Perezin si 9 false. Kjo nuk mund të shpjegohet", - ka thënë babai i Higuainit, Jorge.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Mund të jetë kursimi.
5. Ylli i Nostradamus.
8. Tamam pa kufij.
11. Ross këngëtare.
13. I lashtë.
15. Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
19. Kufijtë e lëvizjes
20. I ka tek plepi.
21. Paguhen për shërbim.
23. Fillojnë lejen.
24. Kufizojnë trotualet.
25. Bëjnë karrierë në parti.
27. Thahet me bonifikim.
28. Mund të jetë unik një i tillë.
29. Preka komik shkordran.
31. Fund dhjetori.
32. Fillojnë aksionin.
33. Ente Operative Tiranë

34. Agjenci Ajrore Durrës.
36. Një pjesë e dimensioneve.
39. Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
41. Kalimi në ekstreme.
42. Eshhtë e re pas Krishtit.
43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
44. Si i gjithë .
47. Kush e thotë lutet.
48. Kufij elementi.
49. Ishite nyja që preu Aleksandri i Madh.
50. Një pjesë e titanëve.
51. Mund të jetë kundërmuese.
52. Pak titanike.

**VERTIKAL**

1. Si i përshtatëshëm.
2. Mund të jenë fetare.
3. Ai i kuq e ka një huq.
4. Pak analogji.
6. Eshhtë metri i rrobaqepësit.
7. Në hyrje të oazit.
8. Arte pa re.
9. Arthur që qe dramaturg.
10. Janë boshte.
12. Michelangelo regjisor.
14. Mund të bëjë stil të lirë .
16. Ishin monedhe te Tobias.
17. Eshhtë bas me katër tela.
18. Pak efikasitet.
22. Eshhtë marrëveshje me nota.
25. Ishite babai i Akilit.
26. Fillojnë nazet.
27. Në krye të kuadrove.
29. Eshhtë faqe muri.
30. Një apendisit i menjëhershëm.
35. Kurosawa që qe regjisor.
36. Vriten nga espada.
37. Eshhtë shtet aziatik.
38. Edouard piktor.
40. Një transporti është kamioni.
45. Uni i Freud.
46. Një cigan.
47. Fundi i një samuraj.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

1. Fillojnë panikun.
3. Gibson aktor.
5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
9. Mund të jetë trofe.
11. Janë vendet si Katari
14. Maureen që qe aktore.
16. Janë kundërmuese.
17. Mund të fitojnë etapa.
20. Ushtojnë nga "ola".
22. Një thirrje
26. Janë ministritë.
27. Një rrugë në Paris.
28. Markë cigareje.
29. Eshhtë ngjinja.
32. Ricciarelli soprano.
33. Fillojnë sefte.


34. Ente Ekonomike Sarandë.
35. Mbyllin një ditar.
36. Satelit i Jupiterit
37. I ka tek Luani.
38. Boldi komik italian.
42. Eshhtë kolana në filma
43. Kush e thotë lutet.
44. Oxa këngëtare.
46. Inicialet e Nolte aktor.
47. Eshhtë tokë që... fitohet.
48. Një... gjermane.

**VERTIKAL**


1. Një votë në favor.
2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
3. Në hyrje makinës.
4. Fillojnë lehtë.
5. Irlanda në Dublin.
6. Eshhtë edhe ajo e historisë.
7. Një pjesë e gamiljeve
8. Notat pa kufij.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gjysma e lutjes.
19. Castellitto aktor.
20. Inicialat e Dalí, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Eshhtë tryzni
24. Në hyrje të Europës.
25. Janë rrobat për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktore.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelitit.
40. Janë teke në sende.
41. Pak marramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Inicialet e Nolte-s.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

			2	6				
5		4		9				
7	3				2	9		
			1			4	9	
9	8		6	5	3			
								8
5		9		8				
8	3		7			9	1	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

2	9	1	8	5	6	4	3	7
8	4	5	3	7	1	6	9	2
3	6	7	9	2	4	5	8	1
1	7	8	2	6	5	3	4	9
4	3	6	7	1	9	8	2	5
5	2	9	4	3	8	7	1	6
9	8	2	5	4	7	1	6	3
6	5	3	1	8	2	9	7	4
7	1	4	6	9	3	2	5	8

*Argëtim filozofik*

- Një vajzë pesëvjeçare pyeti vëllain e saj më të madh: "Çfarë është dashuria?" Ai u përgjigj: "Dashuria është që ti të vjedhësh çokolatën time nga çanta ime dhe unë të vazhdoj ta vendos në të njëjtin vend..."

- "Nuk është mungesa e dashurisë, por mungesa e miqësisë që e bën një martesë të pakënaqur".

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	7	2	7	3	13	2		S	T	A	R	E	T	I	K	E	T	A	T			
2	7	5		8	4	3	5	7	2	6		A	R	M	I	K	S	T	O	L	I	T	E
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2	6	L	I	O	R	O	M	I	N	A	T		
	3	5	8	2	3	5	6	1	7	5		L	O	C	A	B	A	R	E	T	L	A	
12	5	13	5	10	1	7		6		13		A	B	A	T	E	R	I	T	E	A	R	
2	7	18		5	11	2	6	5	8	2	6	T	R	I	M	E	R	I	T	E	A	N	E
8	2	6	2	2	2	1	8	5	11	1		A	R	T	U	R	O	U	I	M	A	T	T
1	6	8		17	9	5	7	2		9		A	R	S	E	N	E	E	A	A			
3	1	5		8	2	16		2	7	1		A	D	A	T	M	E	T	R	I	C		
2			3	2	6	5	9	2		1	13	P	A	K	T	P	I	R	A	T	E	R	I
6	2	7	2			3		7	18	3	6	K	U	A	L	I	T	E	T	I	E	P	
3	4	8	5	19	1	5		3	5	2		L	E	C	E	P	I	N	A	T	A		

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

F	E	R	M	A	N	I	T	J	N	A		
A	K	S	I	L	O	V	A	L	E			
R	O	N	E	P	F	R	E	N	A	T		
A	D	H	I	P	O	K	R	I	T	E	D	
D	E	M	O	S	T	E	N	I	T	K	E	
D	E	K	A	E	T	E	R	E	T	N	O	R
A	M	A	L	I	A	I	Z	E	N	E	A	
D	E	L	E	R	A	E	O	E	T			
A	R	I	E	P	I	T	E	T	E	T		
I	O	M	A	I	D	M	A	D	H	I		
S	R	I	R	I	E	L	I	R	E			
T	E	R	R	O	R	I	A	R	E	N	A	T
L	L	I	S	S	P	A	M	A	L	I	A	
A	L	K	T	R	O	B	E	R	I	A		
P	E	R	I	O	D	I	K	B	N	A		
P	F	I	N	A	L	J	A	A	R	E	N	A
R	E	P	A	R	T	E	T	N	S	I	A	
T	E	R	E	K	S	I	P					
P	A	R	E	T	T	R	U	K	E	T	I	A
A	R	I	T	R	E	A	L	K	U	P	A	
S	T	A	N	F	I	T	I	M	E	T		
T	A	N	D	E	M	N	E	R	E	U	R	
A	H	O	T	E	L	E	T	T	R	A	U	
J	U	K	A	T	E	R						

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

*Thënie të mençura*

- Sa më e thjeshtë është komplikimi i gjërave, aq e komplikuar është thjeshtësimi i tyre.
- Kur dy njerëz zihen, fajin e ka ai që është më i mençur.
- Në një botë ku ju mund të jeni ç'të dëshironi, zgjidhni të jeni vetvetja juaj.
- - Sistemi politik triumfon sepse është një-pakicë bashkuar që vepron kundër shumicës së ndarë.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

www.gsh.al



## Tashmë edhe lundroni!

